



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

## **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit: **MA Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializime)**

**Specializimet:**

**Mësimdhënia e Matematikës**

**Mësimdhënia e Kimisë**

**Mësimdhënia e Biologjisë**

**Mësimdhënia e Historisë**

**Mësimdhënia e Gjeografisë**

**Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut**

**Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

*Niveli i studimeve:*

Master

*Numri i kredive:*

120 ECTS

*Akredituar për periudhën:*

1 Tetor 2024 - 30 Shtator 2027

# 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i programit Master në Mësimdhënie Lëndore është që të avancojë më tutje kompetencat moderne të mësimdhënies dhe të praktikës pedagogjike, krahas atyre akademike, duke marrë për bazë edukimin paraprak dhe nevojat e secilit profil të mësimdhënies lëndore. Qëllimi kryesor i këtij programi është të sigurojë arsim thelbësor për përgatitjen e mësimdhënësve lëndor. Përmes këtij programi, studentët do të fitojnë njohuri të mësimdhënies bashkëkohore, do të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre për të lidhur përmbajtjen e lëndës me ato të fushave të tjera kurrikulare, problemet në jetën e përditshme, pedagogjinë efektive dhe praktikës reflektuese.

Misioni i programit Master në Mësimdhënie Lëndore është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve të ardhshëm lëndor me njohuri rreth lëndës përkatëse dhe aftësi për ta zbatuar atë në mënyra të përshtatshme pedagogjike.

## 2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Janë të definuara në mënyrë specifike për secilin specializim.

### 3. PËRSHKRIMET E KURSEVE TË PËRGJITHSHME

#### Përshkrimi për secilin kurs

##### **TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS**

Kursi ofrohet për të promovuar bazën historike, filozofike e pedagogjike të procesit të nxënimit dhe të mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me kompleksitetin e procesit të të nxënimit, bazën filozofike, e sociale të të nxënimit, teoritë e të nxënimit: teoria bihevoriste, kognitiviste, sociale, konstruktiviste, holistike, humaniste, teoria e procesimit të informacionit etj., stilet e të nxënimit: autitiv, vizuel, kinestetik, global, kronologjik, intuitiv, reflektiv etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë dhe qasjet kryesore kurrikulare dhe efektet e tyre në procesin e të nxënimit dhe mësimdhënies së suksesshme dhe të promovojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ.

##### **PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME**

Përmes këtij kursi synohet që studentët të njoftohen me konceptet bazë të psikologjisë, siç janë shkollat e ndryshme të psikologjisë, metodologjitë e studimit dhe me fushat e veprimtarisë të saj. Në anën tjetër, do të sqarohen bazat biologjike të cilat përbëjnë dhe sqarojnë perceptimet, vëmëndjen, të mësuarit dhe kujtesen ndër tjera procese bazike. Sqarimi dhe ndërlidhja e fenomeneve psikologjike mbi realitetin dhe mjedisin më të cilin njeriu ndërvepron do të jenë çështje të cilat do të ofrojnë një njohuri më koncize rreth ndodhive jetësore. Përpunimi i informatave si një dukuri shumë e rëndësishme e cila ndikon rëndë në funksionimin e individit, lidhur me konceptin e inteligjencës do të shtjellojnë disa nga permisat e interpretimit të realitetit. Përveç, funksionimit normal të proceseve kognitive, do të shpjegohen edhe disa procese anormale, shkaktaret e tyre si dhe forma e identifikimit të çrregullimeve të mundshme, qoftë sepse janë rrjedhojë e një procesi afunksional organik qoftë sepse kanë shkaktarë të jashtëm, ndodhitë jetësore, stresi, apo konsumimi i disa sustancave të caktuara.

##### **METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM**

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimeve në arsim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe

atyre cilësore nga mjediset e të nxënit, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve, Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit. Konceptet e adresuar nga aspekti teorik, do të trajtohen gjithashtu nga qasja praktike (dhe më e detajuar) e realizimit të një projekti hulumtues. Kursi ka për synim t'i ekspozojë studentët ndaj hapave kryesorë nëpër të cilët duhet të kalohet gjatë realizimit të një projekti hulumtues. Kursi trajton metodat kualitative, kuantitative dhe të përziera të hulumtimeve arsimore. Në mënyrë të tërthortë kursi trajton llojet e ndryshme të hulumtimeve si përshkruese, historike, eksperimentale, vlerësuese, vepruese, studime rasti etj. Në kuptim më të ngushtë, kursi ndihmon studentët të familjarizohen me konceptin e zgjidhjes dhe definimit të problemit, dizajnin e një projekti hulumtues, hartimin e instrumenteve dhe mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, si dhe procesimin, analizën dhe raportimin e të dhënave dhe të gjetjeve të një studimi. Në kuptim më të përgjithshëm, kursi ndihmon studentët të reflektojnë rreth parimeve etike ligjore dhe filozofike të realizimit të një projekti hulumtues si p.sh. hulumtueshmëria, besueshmëria, validiteti, përgjithësimi dhe ruajtja e anonimitetit. Natyra e temave dhe problematikës që do të adresojë kursi do të jenë në përputhje me natyrën e programit dhe si të tilla do të orientojnë studentët edhe drejt kuptimit të problemeve dhe çështjeve kryesore brenda fushës së ngushtë të programit.

### **SHKRIMI AKADEMIK**

Kursi Shkrimi akademik ngërthen mësimin dhe studimin teorik dhe praktik të formave themelore të shkrimit akademik dhe funksional-profesional, njohjen dhe aplikimin e kategorive themelore të shkrimit akademik, si eseja, seminari, punimi i diplomës, disertacioni, por edhe letra, telegrami, kumtesa, relacioni, njoftimet (qarkoret), jetëshkrimi (CV-ja), kërkesa dhe procesverbali.

### **KOMUNIKIMI NË ARSIM**

Kursi është i dizajnuar të trajtoj problemin e komunikimit në aspektin teorik dhe atë praktik. Komunikimi në arsim trajton çështjet si: procesi i komunikimit, komunikimi efektiv, parimet për komunikim të efektshëm, komunikimi kompetent, barrierat për komunikim efektiv, komunikimin interpersonal dhe komunikimin në grup të vogël, shkathtësitë e të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe joverbal (nga

perspektiva e nxënësit dhe mësimitdhënësit). Në këtë kurs trajtohen edhe faktorë të cilët ndikojnë në komunikimin në arsim dhe shkathtësitë e nevojshme për të krijuar një komunikim të efektshëm në procesin e edukimit, duke përfshirë këtu edhe komunikimin kolegjal me mësimitdhënës dhe administratën në shkollë si dhe komunikimin e jashtëm si për shembull identifikimi i strategjive të efektshme të komunikimit shkollë-prindër si strategjitë e përmirësimit të arritjeve të nxënësve dhe zhvillimit të shkollës. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e zhvillimit të komunikimit dhe bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e gjërë.

### **SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM**

Kursi synon që të zhvillojë në mënyrë teorike dhe praktike njohuritë lidhur me konceptet dhe llojet kryesore të Teknologjive të reja të Edukimit dhe atyre të Internetit për mbështetje të mësimitdhënies dhe procesit të të nxënësve. Kursi shtjellon konceptet multimediale dhe interaktive në mjedise të reja të mësimitdhënies dhe të të nxënësve. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar: teknologjitë për mësimitdhënie dhe të nxënësve aktiv, TIK-un si medium dhe vegël mbështetëse për praktikatat inkluzive, platformat për mësimitdhënie, simulatorët e ndryshëm për realizimin e eksperimenteve dhe animacioneve kompjuterike në edukim, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga kompjuteri, teknologjitë për vlerësim, teknologjitë e të nxënësve elektronik në kontekst, si dhe teknologjitë për krijimin e materialeve interaktive që mundësojnë mësimitdhënie dhe të nxënësve interaktiv. Studentët poashtu mësojnë se si t'i vlerësojnë Teknologjitë e Edukimit dhe ato të Internetit për nga aspekti i ngritjes së performancës së mësimitdhënies dhe të nxënësve për të mbështetur të menduarit kritik, kreativitetin, inovacionin, monitorimin dhe aktivitetet mësimore në një perspektivë gjithëpërfshirëse.

### **PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE**

Kursi trajton aspektet e lidhura me aspektin personal të nxënësve kundrejt mësimit si motivacioni dhe shtytja për nxënie. Nga këndvështrimi i teorisë së procesimit të informacionit ku nxënësi është në qëndër të vëmëndjes, do të trajtohen edhe metodat psikologjike bashkëkohore mbi përpunimin e të dhënave lidhur me nxënien, rëndësia e njohurive paraprake, mënyre aktuale e të mësuarit dhe ndërlidhja mes tyre si proces i suksesshëm për përvetësimin e njohurive dhe ruajtjen e tyre afatgjatë. Në psikologjinë e zbatuar në kontekstin mësimitdhënie/mësimnxënie luajn rol kyq teknikat e ndryshme të nxënësve lidhur me procesin e

kushtëzimit operant, andaj do të shpjegohen brenda kursi ashtu si dhe mënyra e zbatimit të tyre për ngritje të efektivitetit dhe efikasitetit të procesit nxënës. Kursi po ashtu trajton edhe aspektet e ndërtimit të raporteve të rëndësishme mes biologjisë dhe psikologjisë për të arritur e shpjeguar më së miri sjelljen dhe kognicionin njerëzor.

### **POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI**

Kursi ofron mundësi për studentët të njihen me ciklin e zhvillimit të politikave arsimore si dhe me politikat aktuale në fuqi si dokumente kurrikulare, strategjitë dhe politikat e ndryshme të standardeve të mësimdhënies si licencimit i mësimdhënësve, orientimet e kurrikulës shkollore, standardet e performancës së drejtorëve të shkollave etj. Kursi gjithashtu ofron mundësi për studentët të njihen me dokumentet kryesore legjislative në sistemin e arsimit në Kosovë si ligjet e arsimit dhe udhëzimet e ndryshme administrative që rregullojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemit arsimor në Kosovë.

### **MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR**

Në kuadër të këtij kursi fillimisht trajtohen tema që kanë të bëjnë me të kuptuarit, arsyeshmërinë e mësimdhënies së diferencuar dhe rolin e mësimdhënësit në zbatimin e mësimin të diferencuar. Në pjesën tjetër, trajohen tema që kanë të bëjnë me modalitetet e diferencimit: diferencimi i përmbajtjes, diferencimi i procesit dhe diferencimi i produktit (rezultatit), pastaj menaxhimin e klasave të diferencuara, mjedisi i të nxënësve, strategjitë e mësimdhënies për mësimin e diferencuar, si dhe planifikimi i mësimdhënies për klasat e diferencuara duke përfshirë edhe punën me nxënës të talentuar. Kursi adreson mësimin e diferencuar apo individualizuar jo vetëm nga perspektiva e integritetit dhe inkluzionit por edhe nga perspektiva e qasjes së mësimdhënies me nxënës në qendër.

### **UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM**

Kursi adreson aspektet të udhëheqjes dhe menaxhimit të shkollës duke përfshirë teorinë dhe stilet e ndryshme të menaxhimit dhe udhëheqjes si dhe aspekte të menaxhimit të shkollës si institucion. Kursi adreson dimensionet e një shkolle cilësore dhe atributet e një udhëheqësi të mirë dhe ndikimi i tij/saj në performancën dhe zhvillimin e shkollës si organizatë. Kursi adreson edhe aspektet e ndryshimeve në arsim duke përfshirë ndërlidhjen e reformës arsimore me rolin

e drejtorit si dhe qasjen sistematike ndaj realizimit të ndryshimeve dhe reformave në arsim. Studentët do të ekspozohen ndaj sfidave dhe mundësive të realizimit të reformës arsimore duke u mbështetur në teoritë dhe përvojat e mira ndërkombtare si dhe do të analizojnë gjendjen aktuale të reformës arsimore në Kosovë dhe rrugën që duhet të ndiqet.

### **FILOZOFI E EDUKIMIT**

Në pjesën e parë të kursit ofohen përmbajtje thelbësore për historikun e edukatës, filozofinë esencialiste dhe ekzistencialiste, filozofinë progresiviste dhe pragmatiste, konstruktivizmin si dhe rrymat e tjera filozofike që formësojnë bazën e funksionimit të arsimit. Në pjesën e dytë ofrohen përmbajtje për rëndësinë e edukimit në formimin e individit dhe të shoqërisë, për tiparet e sistemit arsimor demokratik, për edukimin demokratik, edukimin global, edukimin për paqë dhe tolerancë, edukimin për qytetari demokratike, për misionin dhe tiparet e mësuesit të shkollës bashkëkohore, për rolin e shkollës në orientimin e të rinjëve në profesione të dëshirueshme. Gjithashtu, ofrohen përmbajtje thelbësore për çështjet e përgjithshme të pedagogjisë sistematike, përkatësisht për komponentet e edukatës fizike-shëndetësore, intelektuale, morale, estetike e punuese.

### **PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV**

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të edukimit inkluziv, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vende evropiane e më gjerë, nxënësit me nevoja të vecanta, dëmtimet e natyrave të ndryshme: në të dëgjuar, në të parë, prapambetje mendore, vështirësi në komunikim, vështirësi emocionale dhe në sjellje. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave dhe tendencave të edukimit inkluziv në vende të ndryshme të botës duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm dhe të zbatimit parimeve, strategjive të edukimit inkluziv të cilat shpijnë në drejtim të krijimit të një klase, një mësimdhënësi një shkollë dhe një sistemi arsimor inkluziv.

### **VLERËSIMI NË ARSIM**

Kursi shqyrton aspektet dhe praktikat e vlerësimit që influencojnë cilësinë e mësimdhënies dhe reformën në shkollë në përgjithësi. Në mënyrë më të theksuar, kursi adreson aspektet e planifikimit dhe realizimit të vlerësimit të sipas qasjes së

bazuar në kompetenca në kuadër të reformës kurrikulare në Kosovë. Kursi adreson edhe aspektet tjera të vlerësimi si: natyra dhe qëllimet e vlerësimit, ndërlidhja e vlerësimit me mësimdhënien, llojet e vlerësimit. Për më shumë, kursi trajton në hollësi edhe llojet e ndryshme të vlerësimit si vlerësimi i vazhdueshëm, vlerësimi për të nxënë (formativ) dhe vlerësimi i të nxënës (përmbledhës) si dy koncepte që formësojnë vlerësimin që i bëjnë mësimdhënësit nxënësve ndërsa nga aspekti praktik kursi ekspozon nxënësit ndaj metodave të ndryshme të vlerësimit si: vlerësimi i bazuar në portfolio, vlerësimi i punimeve të shkruara, testet dhe cilësia e tyre etj. Përveq kësaj, kursi adreson edhe aspektet sistematike të vlerësimit si vlerësimet e jashtme kombtare dhe vlerësimi i programeve.

### **EDUKIMI PËR ZHVILLIM TE QËNDRUESHËM**

Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës Kurrikulare si çështje ndërkurrikulare që nga viti 2016. Studenti-mësimdhënës me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socio-ekonomik si dhe rolin e edukimit të gjërnatave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.

### **TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM**

Kursi adreson aspektet e ndryshme të zhvillimeve të fundit në sistemin arsimor në nivel ndërkombtar dhe më veqant në sistemin arsimor në Kosovë. Një nga temat kryesore është ndryshimi i vazhdueshëm i rolit të mësimdhënësit në krijimin shoqërinë post-moderne dhe kohët e globalizimit. Gjithashtu, kursi adreson edhe zhvillimet aktuale në decentralizimin e kompetencave të sistemit të arsimit dhe fuqizimin e autonomisë së shkollave dhe rolit të mësimdhënësit si dhe konceptin e krijimit të shoqërisë së dijes. Kursi poashtu adreson edhe tendencat e zhvillimit të mësimdhënies dhe mësimin elektronik si dhe tendencat e përafërimit të standardeve të sistemeve të arsimit me politikën dhe standardet e Bashkimit Europian dhe më gjërë.

### **VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË**

Ky kurs trajton gjendjen e vështirësive në të nxënë, çështje kjo e njohur dhe e pranuar tashmë në përmasa të gjera e cila çon drejt vështirësive serioze në të



nxënit shkollor dhe shpesh edhe në jetën e mëvonëshme të të rriturit. Kursi ofron njohuri teorike dhe shkathtësi praktike për të kuptuarit e drejtë të natyrave të ndryshme të vështirësive në të nxënë si pasojë e ngecjes së zhvillimit mendor, dëmtimeve të natyrës fizike e me theks të vecantë të vështirësive specifike në të nxënë si: disleksia, disgrafia, diskalkulia, dispraksia. Gjithashtu, ofon edhe njohuri rreth identifikimi të nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe përpjekjet e s sfidat me të cilat ata përballen, mënyrën e adresimit më të mirë të nevojave të tyre, si dhe rolin që mësimit dhe prindërit luajnë në jetën e tyre.

### **ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE**

Kursi adreson aspekte të përgjithshme të mësimit tërëjetësor dhe me fokus të veçant në të kuptuarit e rëndësisë dhe modaliteteve të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve. Kursi adreson modele të ndryshme të zhvillimit profesional si modeli me bazë në shkollë, modeli i trajnimit të trajnerëve duke identifikuar përparësitë dhe mangësitë e secilit model. në anën tjetër kursi adreson aspektet e të mësuarit profesional të mësimitdhënësve duke elaboruar modalitetet e zhvillimit të mësimitdhënësve si psh mentorimi i mësimitdhënësve, reflektimi, planifikimi kolegjal etj. Për më shumë kursi adreson dimenzionet teorike dhe praktike të procesit në të cilin angazhohen mësimitdhënësit për të kuptuar punën e tyre dhe identifikuar format e tejkalimit të sfidave në baza të vazhdueshme.

### **STATISTIKA NË ARSIM**

Ky kurs diskuton disa nga aspektet matematikore dhe shkencore të të dhënave empirike, ose të dhënave të bazuara në zgjidhjen e problemeve. Temat do të përfshijnë metodat për hartimin e eksperimenteve dhe anketimeve; dhe analizën e të dhënave duke përdorur modele statistikore. Shembujt do të ilustrojnë zbatimin e këtyre metodave në shkencat e edukimit në përgjithësi dhe në fushën e edukimit matematikor në veçanti.

### **EDUKIMI PËR STEM**

Ky kurs do të ofrojë një qasje ndërdisiplinore për integrimin e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM), në praktikën e mësimitdhënies në të gjitha disiplinat dhe të gjitha nivelet. Kursi do të përfshijë pjesëmarrjen në aktivitetet e të nxënit të bazuar në probleme, të nxënit e bazuar projekte dhe të nxënit e bazuar në hulumtime, duke përdorur teknologjinë për të fituar dhe shfaqur informacion. Në kurs do të adresohet natyra e disiplinave të edukimit per

STEM, pedagogjia e STEM, strategjitë e mësimdhënies, mësimi integruar STEM dhe udhëzimet për zgjidhjen e problemeve. Studentët do të jenë të angazhuar përmes aktiviteteve të shumta praktike të orientuara drejt integritit të secilës prej disiplinave STEM. Gjatë kursit do të inkurajohet të menduarit kritik e krijues dhe bashkëpunimi gjatë zgjidhjes së problemeve.

#### **HULUMTIMI NË VEPRIM**

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e matematikës. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës do të shërbejë jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënien dhe të nxënies së matematikës por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim.

#### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE**

Komponenti i Mësimi praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturave nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat.

Qëllimi parësor i komponentit të Mësimi praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

## TEZA E MASTERIT

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
2. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.

Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 4. SPECIALIZIMI NË MATEMATIKË

### 4.1. Qëllimi i Specializimit

Specializimi Matematikë, në programin Master i Mësimdhënies Lëndore, si program ndërdisiplinar i studimeve pasuniversitare të organizuara në Universitetin e Prishtinës, është i projektuar për studentët, të cilët janë të interesuar për t'u përgatitur për mësimdhënie në lëndën e matematikës. Qëllimi i tij, është ofrimi i arsimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit profesional për mësimdhënësit e lëndës së matematikës. Në këtë kontekst, programi ofron edukim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi, si dhe në lëndën e matematikës në veçanti. Studentët do të marrin njohuri kryesore nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore në lëndën e matematikës, do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e tyre në këtë aspekt. Gjithashtu, atyre iu ofrohen mundësi që të zgjedhin kurse të ndryshme (zgjedhore) sipas preferencave dhe interesave personale, të cilat janë të ofruara në kuadër të këtij programi të studimit.

### 4.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimet në fushën e edukimit.
2. Krijojnë mjedis të përshtatshëm të të nxënësve për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
3. Zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të burimeve të të mësuarit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë.

4. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh.: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta (duke përfshirë edhe nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
5. Demonstrojnë të kuptuarit dhe aftësi për planifikim, zbatim dhe vlerësim efektiv të përmbajtjeve nga matematika nëpërmjet zbatimit të strategjive të mësimdhënies me nxënësin në qendër.
6. Reflekojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë teoritë, metodologjitë dhe praktikën e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënies së matematikës në veçanti.
7. Analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme matematikore dhe në mënyrë efektive arsyetojnë, komunikojnë dhe i zbatojnë idetë matematikore në praktikën mësimore dhe fenomenet nga jeta e përditshme dhe fushat tjera lëndore.
8. Zotërojnë aftësi për të modeluar, formuluar dhe për të zgjidhur probleme matematikore, duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre:
9. Demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në funksion të mirëqenies së të gjithë nxënësve, zhvillimit të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend:
10. Shqyrtojnë ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikave arsimore të vendit, duke reflektuar për praktikën e tyre personale dhe zhvillimin e tyre profesional.

### 4.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË MATEMATIKË					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	6 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E MATEMATIKËS I	3	2	6 ECTS
5.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	MËSIMDHËNIA E ALGJEBRËS MËSIMDHËNIA E GJEOMETRISË	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E MATEMATIKËS II	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM ETIKA E MESIMDHENESIT	2	0	4 ECTS
6.	Z	ARSYETIMI MATEMATIKOR DHE VËRTETIMET HISTORI E EDUKIMIT MATEMATIKOR ZGJIDHJA E PROBLEMEVE MATEMATIKORE	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Viti II					
Semestri III			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS

2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV	3	0	4 ECTS
3.	O	HULUMTIMET NË EDUKIMIN MATEMATIKOR	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TE QËNDRUESHËM TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	0	4 ECTS
7.	Z	VLERËSIMI NË MATEMATIKË STATISTIKA NË ARSIM EDUKIMI PËR STEAM	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
<b>Semestri IV</b>					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 4.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E MATEMATIKËS I**

Përmbajtja e shkurtër: Lënda është planifikuar të zhvillojë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për mësimdhënie të matematikës në shkollat e mesme të ulëta dhe ato të larta. Temat që përmban kursi përfshijnë zhvillimin e të kuptuarit në matematikë, kompetencat matematike dhe konceptet themelore që përfshihen në fushën kurrikulare të matematikës. Në këtë lëndë shqyrtohen edhe teoritë e të nxënit në edukimin matematikor, planifikimi për mësimdhënie, vlerësimi qëllimet dhe strategjitë, mësimdhënien përmes zgjidhjes së problemeve, integrimii e teknologjisë dhe fushave tjera kurrikulare në mësimdhënie dhe të nxënit e matematikës. Studentët do të shqyrtojnë probleme të ndryshme, do të hulumtojnë dhe analizojnë situata të ndryshme dhe do të reflektojnë për mësimdhënien me nxënësin në qendër me qëllim të zhvillimit të njohurive, shkathtësive matematikore dhe vlerave të bazuara në parimet kryesore të Kurrikulës së Kosovës.

#### **MËSIMDHËNIA E ALGJEBRËS**

Ky kurs fokusohet në shqyrtimin e metodave të mësimdhënies për numrat racional, ndryshoret dhe shprehjet, ekuacionet dhe inekuacionet, sistemet e ekuacioneve lineare dhe funksionet algjebrike. Poashtu analizohen idetë themelore dhe keqëkuptimet, perspektivat e ndryshme të paraqitjes së këtyre temave dhe mundësitë e lidhjes së tyre me botën reale. Studentët do të shqyrtojnë modele pedagogjike të mësimdhënies dhe të nxënit, duke u bazuar në studimet empirike për të nxënit dhe mësimdhënien, planifikimin e njësive mësimore dhe kurrikulën shkollore.

#### **MËSIMDHËNIA E GJEOMETRISË**

Ky kurs mbështet studentët për zhvillimin e të kuptuarit të çështjeve pedagogjike dhe matematike që lidhen me të nxënësit dhe mësimdhënien e gjeometrisë në klasat 6-12. Kursi do t'iu mundësojë studentëve të lidhin aspektet teorike të mësimdhënies me praktikën mësimore duke u bazuar në hulumtimet e fundit për mësimdhënien e gjeometrisë dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie.



## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I**

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

## **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E MATEMATIKËS II**

Kjo lëndë është vazhdim i lëndës Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës I. Studentët do të zhvillojnë në mënyrë të veçantë shkathtësi për zhvillimin mësimdhënies për koncepte më komplekse, zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik. Ata do të aftësohen që të përshtatin njohuritë specifike të lëndës së matematikës me praktikën bashkëkohore pedagogjike, do të zhvillojnë planifikime për zhvillimin e të kuptuarit të numrave, koncepteve nga gjeometria, algjebra, statistika, trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti. Strategjitë metakognitive për zgjidhjen e problemeve, ahqyrtimi i Teorisë Realiste Matematikore (RME), Teoria e Van-Hiele për të menduarit gjeometrik dhe modelimet matematikore do të jenë bazë për reflektimin për aspektet teorike dhe ato praktike të mësimdhënies dhe zgjidhjen e problemeve kontekstuale. Në këtë lëndë, vend të rëndësishëm zë edhe mësimdhënia e bazuar në hulumtime, edukimi për STEM dhe shqyrtimi i rolit të matematikës në fushat tjera kurrikulare dhe jeta e përditshme.

## **ARSYETIMI MATEMATIKOR DHE VËRTETIMET**

Kursi fokusohet në njërin nga aspektet më të rëndësishme të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit të matematikës. Në kurs do të shqyrtohet nevoja për

vërtetimin në matematikë, mundësia e shfrytëzimit të llojeve të ndryshme të vërtetimeve dhe arsytimit logjik. Studentët do të angazhohen në mënyrë aktive për të shqyrtuar temat nga logjika matematikore, sistemet deduktive, teoria e bashkësive, induksioni matematik dhe vërtetimet në teorinë e grupeve dhe në analizën reale. Poashtu, pjesë e kursit është edhe leximi dhe shkrimi i vërtetimeve në matematikë.

### **HISTORI E EDUKIMIT MATEMATIKOR**

Ky kurs ofron një retrospektivë të shkurtër të zhvillimit të matematikës, si dhe një lidhje midis koncepteve dhe rezultateve matematikore nga periudha të ndryshme historike me konceptet dhe rezultatet e matematikës bashkëkohore. Qasja do të jetë kronologjike nga periudha e qytetërimit antik deri në dekadat e fundit të shekullit të 20-të. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet biografive të personaliteteve që kanë kontribuar në zhvillimin e matematikës nga periudha antike deri në historinë moderne, si dhe në evoluimin e koncepteve dhe pohimeve matematikore që kanë vendosur themelet për zhvillimin e teorive të reja që kanë rezultuar në aplikime të shumta të matematikës. në disiplina të tjera të shkencës.

### **ZGJIDHJA E PROBLEMEVE MATEMATIKE**

Kursi synon të shpalosë rëndësinë dhe rolin e çasjeve kontekstuale në përmbajtjet e matematikës shkollore. Poashtu, kursi synon të eksploroj strategjitë dhe heuristikat për zgjidhjen e problemeve kontekstuale. Mësimdhënësi i matematikës duhet ta ketë të qartë faktin se matematika shkollore nuk është disiplinë e izoluar dhe abstrakte, por është një prodhim i natyrës në shërbim të shoqërisë bashkëkohore. Ky kurs tenton ta vë në qendër këtë fakt.

### **HULUMTIMET NË EDUKIMIN MATEMATIKOR**

Fokus kryesor i këtij kursi është të shqyrtojë hulumtimet aktuale në edukimin matematik dhe të diskutojë çështjet që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit e matematikës. Nga kjo bazë, studentët do të identifikojnë metodat e hulumtimit në edukimin matematik, do të analizojnë rezultatet e hulumtimeve, formulojnë pyetje kërkimore dhe zhvillojnë planin e tyre të hulumtimit dhe shqyrtojnë literaturën përkatëse. Nëpërmjet shqyrtimit të literaturës dhe hulumtimeve individuale dhe në bashkëpunim nga fusha e edukimit matematik do të shqyrtohen lidhjet mes hulumtimeve dhe praktikave mësimore për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit të matematikës.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundur nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimin praktik në shkolla i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **VLERËSIMI NË MATEMATIKË**

Ky kurs diskuton një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me vlerësimin në lëndën e matematikës në të gjitha nivelet, duke përfshirë vlerësimin në klasë, shkollë, vlerësimet shtetërore (Provimi i arritshmërisë dhe i Maturës Shtetërore) dhe ato ndërkombëtare. Përveç kësaj, çështjet që lidhen me vlerësimin formativ, sumativ dhe vlerësimet alternative të cilat diskutohen nga perspektiva kurrikulare dhe ajo e hulumtimeve në vend dhe në nivel ndërkombëtar.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Praktika pedagogjike III përfshinë dy komponente të lidhura ngushtë. Pjesën teorike dhe reflektive në kampus dhe pjesën e mësimit praktike në shkollë.

- Pjesa e kursit e zhvilluar në kampus, pra, ka dy qëllime kryesore: (1) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në praktikë në shkollë; (2) t'u ofrojë studentëve mundësi, kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim të praktikës në shkollë.
- Mësimi praktik në shkollë synon të zhvillojë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet e domosdoshme për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të lartë. Këtu përfshihen idejimi, ndërtimi dhe zbatimi i strategjive e teknikave për mësimdhënie, vlerësim dhe organizim në nivel klase si dhe ndërtimi e përdorimi i mjeteve tekstuale, teknologjike e fizike për zhvillimin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Poshtu, këtu

nënkuptohej edhe zhvillimi i aftësive për planifikim bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare.

### **STATISTIKA NË ARSIM**

Ky kurs diskuton disa nga aspektet matematikore dhe shkencore të të dhënave empirike, ose të dhënave të bazuara në zgjidhjen e problemeve. Temat do të përfshijnë metodat për hartimin e eksperimenteve dhe anketimeve; dhe analizën e të dhënave duke përdorur modele statistikore. Shembujt do të ilustrojnë zbatimin e këtyre metodave në shkencat e edukimit në përgjithësi dhe në fushën e edukimit matematikor në veçanti.

### **HULUMTIMI NË VEPRIM**

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e matematikës. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës do të shërbejë jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënien dhe të nxënies së matematikës por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimi praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjëratat në aktivitete mësimore, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimi praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë,

përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimeve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

**Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësime në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësime. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimi praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimeve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimi praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimeve dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimi praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimi praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimeve duhet të mbikëqyret nga

metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.
- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

#### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.  
1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studentin në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet

me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.

6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 5. SPECIALIZIMI NË KIMI

### 5.1 Qëllimi i Specializimit

Specializimi Kimi, në programin Master i Mësimdhënies Lëndore, si program ndërdisiplinar i studimeve pasuniversitare të organizuara në Universitetin e Prishtinës. Programi është i projektuar për studentët që janë të interesuar për t'u përgatitur për mësimdhënie në lëndën e kimisë. Qëllimi i tij, është ofrimi i arsimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit profesional për mësimdhënësit e lëndës së kimisë. Në këtë kontekst, programi ofron edukim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi si dhe në lëndën e kimisë në veçanti. Studentët do të marrin njohuri kryesore nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore në lëndën e kimisë, do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë si dhe kompetencat e tyre në këtë aspekt. Gjithashtu, atyre iu ofrohen mundësi që të zgjedhin kurse të ndryshme (zgjedhore) sipas preferencave dhe interesave personale, të cilat janë të ofruara në kuadër të këtij programi të studimit.

### 5.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimet në fushën e edukimit.
2. Krijojnë mjedis të përshtatshëm të të nxënësve për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
3. Zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të burimeve të të



mësuarit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë.

4. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta (duke përfshirë edhe nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
5. Demonstrojnë të kuptuarit dhe aftësi për planifikim, zbatim dhe vlerësim efektiv të përmbajtjeve nga kimia nëpërmjet zbatimit të strategjive të mësimdhënies me nxënësin në qendër.
6. Reflekojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë aspektet teorike, metodologjite dhe praktikatat e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënies së kimit në veçanti.
7. Analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme nga kimia dhe, në mënyrë efektive, arsyetojnë, komunikojnë dhe i zbatojnë idetë shkencore nga kimia në praktikën mësimore dhe fenomenet nga jeta e përditshme dhe fushat e tjera lëndore.
8. Zotërojnë aftësi për të modeluar, formuluar dhe për të zgjidhur probleme nga kimia, duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre.
9. Demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në funksion të mirëqenies të të gjithë nxënësve, zhvillimit të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend.
10. Shqyrtojnë ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikave arsimore të vendit, duke reflektuar për praktikatat e tyre personale dhe zhvillimin e tyre profesional.

### 5.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË KIMI					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	6 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E KIMISË I	3	2	6 ECTS
5.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	NATYRA E TREFISHTË E KONCEPTEVE KIMIKE TË NXËNIT INTERDICIPLINAR NË KIMI	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E KIMISË II	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM ETIKA E MËSIMDHËNIES	2	0	4 ECTS
6.	Z	DIZAJNIMI I EKSPERIMENTIT PËR MËSIMDHËNIE EDUKIMI PËR ZHVILLIM TE QËNDRUESHËM KEQKONCEPTIMET NË TË NXËNIT E KIMISË	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Viti II					
Semestri III			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV	3	0	4 ECTS

3.	O	TË NXËNIT PËRMES EKSPERIMENTEVE	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE STATISTIKA NË ARSIM	2	0	4 ECTS
7.	Z	EDUKIMI PËR STEAM HULUMTIMET NË EDUKIMIN NGA KIMIA VLERËSIMI NË EDUKIM NGA KIMIA	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
<b>Semestri IV</b>					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 5.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **MËSIMDHËNIA DHE NXËNIT E KIMISË I**

Në këtë kurs do të shpalosen bazat e hartimit të kurrikulës për mësimdhënien e kimisë. Kursi do të sigurojë studentin me njohuritë kurrikulare dhe pedagogjike të nevojshme që ata të arrijnë të kuptojnë nevojat e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta për mësimnxënie efektive nga kimia përbrenda dhe rreth përmbajtjes mësimore. Rëndësi të veçante për diskutim do të kenë strategjitë dhe metodat aktuale të mësimdhënies për të nxënëit e kimisë në shkollat e mesme të ulëta dhe të larta, si dhe qasjeve të reja relevante për mësimdhënien e kimisë duke u bazuar në dokumentet kurrikulare në Kosovë. Midis çështjeve të tjera që do të diskutohen në kontekst të mësimdhënies nga kimisë janë: teoritë e mësimdhënies, stilet e të mësuarit, zgjidhja e problemeve, keqkuptimet, puna laboratorike, roli i punës laboratorike në të mësuarit efektiv, dhe demonstrime të tjera të mësimdhënies dhe të nxënëit nga kimia.

#### **NATYRA E TREFISHTË E KONCEPTVE KIMIKE**

Në këtë kurs fillimisht do të paraqitet zhvillimi historik i përdorimit të natyrës së trefishtë të koncepteve shkencore/kimike në mësimdhënien dhe të nxënëit e shkencës së kimisë dhe ndikimi i saj në performancën shkencore të nxënësve. Gjithashtu do të paraqitet dhe analizohet natyra e trefishtë e koncepteve kimike, pra niveli makroskopik, submikroskopik dhe simbolik. Pasi që rëndësia e natyrës së trefishtë të koncepteve kimike përcaktohet dhe diskutohet, studentët do të analizojnë dhe hulumtojnë përfshirjen e koncepteve kimike në të tri nivelet në tekstet shkollore para-universitare Studentët gjatë këtij kursi do të fitojnë njohuri për hetuar dhe identifikuar koncepte të tilla në resurset mësimore që i përdorin dhe njëkohësisht të dizajnojnë, integrojnë teknologjinë, organizojnë dhe menaxhojnë plane mësimore duke trajtuar konceptet kimike në të tri nivelet. Studentët do të jenë në gjendje të bëjnë identifikimin e parakoncepteve, trajtimin dhe ri-ndërtimin e modelit mendor duke trajtuar konceptet në të tri nivelet.

#### **TË NXËNIT INTERDICIPLINAR NË KIMI**

Ky kurs ka për qëllim të ndërlihd konceptet themelore shkencore të jetës përreth nesh, dhe të vë në pah se si kimia i shpjegon shumë nga këto fenomene që

ndodhin. Kimia poashtu është shkencë që ka kontribut edhe në shkencat tjera, duke ndikuar në zhvillimin e hovshëm të tyre dhe duke i bërë të sukseshme në studime eksperimentale. Si psh në biologji, kimia shpjegon se si rekasionet zhvillohen në çdo organizëm. Poashtu kimia shpjegon lidhshmërinë në mes të kafshëve dhe bimëve duke e ilustruar me ciklin oksigjen-karbon. Fizika është shkencë që meret me lëvizjen, forcën dhe energjinë, mirëpo kur lëvizja dhe forca e një objekti varet nga sasia e substancës atëherë këtu vihet në pah lidhshmëria me kiminë.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I**

Mësimi praktik përfshinë dy komponentë të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **MËSIMDHËNIA DHE NXËNIT E KIMISË II**

Ky kurs do vazhdojë të shqyrtojë problemet kurrikulare të mësimdhënien dhe të nxënien nga kimia për shkollat e mesme të ulët dhe të lartë. Modele për shqyrtim, duke përfshirë analizë të situatës, diskutim të problemeve dhe formulimin e tyre, zhvillimet alternative, dhe pasojat e pritshme, do të zhvillohen dhe do të ilustrohen. Këto modele do të vihet në kontrast me përshkrimet dhe planifikimet e tjera të kurrikulës. Çdo student do të ketë mundësi të përshkruaj ne formë sistematike formulimin e një problemi të kurrikulës dhe një plan të veprimit për zgjidhjen e atij problemi. Njëkohësisht, në këtë kurs, do të ofrojmë një mundësi për të zhvilluar plane mësimore të cilat do të zhvillojnë te kuptuarit e studenteve për një të nxënë të suksesshëm të nxënësve të shkollave të mesme të ulët dhe të lartë. Do të dëgjojmë zërin kritik të tyre, dhe përfshirjen e studenteve në ndryshimet që duhet të ndodhin në shkollë. Mësimdhënësit e ardhshëm gjatë këtij

kursi do të mësojnë të mendojnë me shumë kujdes për atë që përbenë sot, dhe duhet të përbëjë kurrikula nga lënda e kimisë dhe të bashkëpunojnë në hartimin e kurrikulës, në organizimin e mësimdhënien dhe të nxëniet nga Kimia në klasa, shkollë, dhe komunitetet.

### **DIZAJNIMI I EKSPERIMENTIT PËR MËSIMDHËNIE**

Ky kurs ka për qëllim të aftësoj studentët me njohuri se si të dizajnohet një eksperiment ashtu që eksperiencia laboratorike të përputhet me përmbajtjen e njësisë mësimore. Studentët poashtu do të fitojnë aftësi rreth hapave që duhet ndjekur për të dizajnuar një eksperiment deri te dizajnimi i një instrumenti posteksperimental për të identifikuar arritjen e rezultateve të të nxëniet. Dizajnimi eksperimentit do të ngërthej në vete edhe përdorimin e modeleve të ndryshme të instrumenteve (bazuar në hulumtimet e fundit) të cilat mund të përdoren si fleraporte gjatë zhvillimit të eksperimentit.

### **KEQKONCEPTIMET (MISCONCEPTIONS) NË TË NXËNIT E KIMISË**

Ky kurs ka për qëllim të studioj parimet e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave për të identifikuar keqkonceptimet e nxënësve për konceptet në kimi. Keqkonceptimet luajnë një rol të madh në të mësuarit e kimisë duke prodhuar shpjegime shpjegime joadekuate. Studentet me vetedije apo pavetëdije ndërtojnë shpjegime konceptuale gjatë eksperiencave të tyre. Ata besojnë se shumica e këtyre shpjegimeve janë të sakta, sepse këto shpjegime kanë kuptim në kuptimin e sjelljes së botës rreth tyre. Është me rëndësi të madhe të identifikohen idetë e gabuara të nxënësve, duke përdorur diagnostikuesit, përballjen me nocionet e gabuara, duke pritur që keqkonceptimet përfundimisht të eliminohen, korrigjohen dhe zëvendësohen me ato që janë të sakta dhe të qëndrueshme. Studentët gjatë këtij kursi do të fitojnë njohuri i për pikëpamjet themelore rreth mësimin të konceptit, aplikimit të metodave për të përcaktuar idetë e gabuara të nxënësve dhe procedurat e aplikimit të këtyre metodave. Poashtu studentët do të fitojnë aftësi për të përcaktuar keqkonceptimet rreth koncepteve themelore të kimisë.

### **TË NXËNIT PËRMES EKSPERIMENTEVE**

Ky kurs ka për qëllim të pajisë mësimdhënësit e ardhshëm me një makro eksperiencë në transmetimin e eksperimenteve laboratorike, demonstrimin e tyre, dhe përdorimin e strategjive të mësimdhënies përmes eksperimentit. Kursi ofron një qasje interaktive të eksperimenteve me përmbajtje tematike të ndryshme nga

lënda e kimit (kimi të përgjithshme, inorganike, analitike dhe fizike). Eksperimentet do të sfidojnë dhe motivojnë studentët duke ju dhënë një mundësi të drejtpërdrejtë për të fituar aftësi/shkathtësi shkencore të mësimdhënies të cilat duhet t'i transmetojnë si mësimdhënës të ardhshëm dhe të bëjnë ndërlidhjen me jetën reale. Pjesëmarrja në eksperimente promovon të mësuarit aktiv, duke i inkurajuar studentët të pyesin, të eksplorojnë dhe për të vendosur një lidhje midis nocioneve teorike dhe zbatimeve praktike. Të nxënit përmes eksperimentit për konceptet dhe teoritë komplekse, për më tepër përgatit ata për karriera të mundshme që kërkojnë aftësi thelbësore praktike.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimin praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **HULUMTIMI NË EDUKIMIN NGA KIMIA**

Fokus kryesor i këtij kursi është të shqyrtojë hulumtimet aktuale në edukimin nga kimia dhe të diskutojë çështjet që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit e kimit. Nga kjo bazë, studentët do të identifikojnë metodat e hulumtimeve në edukimin nga kimia, do të analizojnë rezultatet e hulumtimeve, formulojnë pyetje kërkimore dhe zhvillojnë planin e tyre të hulumtimit dhe shqyrtojnë literaturën përkatëse. Nëpërmjet shqyrtimit të literaturës dhe hulumtimeve individuale dhe në bashkëpunim nga fusha e edukimit nga kimia do të shqyrtohen lidhjet mes hulumtimeve dhe praktikave mësimore për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit të kimit.

## **VLERËSIMI NË EDUKIMIN NGA KIMIA**

Kursi do të fokusohet në shqyrtimin e vlerësimit shikuar nga këndi i shkencës së kimisë, këndin etik dhe psikologjik, ndërlidhjen e vlerësimit me të nxënit nga kimia, llojet e vlerësimit në shkencën e kimisë, si vlerësimin laboratorik, vlerësimin e projekteve të ndryshme nga kimi. Ky kurs, rëndësi të veçante do ti kushtojë vlerësimit me qëllim mësimnxënien, vlerësimin e vazhdueshëm në klasë, vlerësimin përmbledhës, zbatimin e vlerësimeve të standardizuara kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare, si TIMSS (Trendet në Studimin Ndërkombëtar të Materimatikës dhe Shkencës) dhe PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve), vlerësimin e programeve, vlerësimin përmes portofolios, vlerësimin e punimeve të shkruara, etj. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e ndryshme të standardeve të arsimit në nivele dhe kontekste të ndryshme (në nivel vendi dhe ndërkombëtar) duke përfshirë edhe procesin e caktimit të standardeve në arsim.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Praktika pedagogjike III përfshinë dy komponente të lidhura ngushtë. Pjesën teorike dhe reflektive në kampus dhe pjesën e mësimin praktikë në shkollë.

- Pjesa e kursit e zhvilluar në kampus, pra, ka dy qëllime kryesore: (1) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në praktikë në shkollë; (2) t'u ofrojë studentëve mundësi, kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim të praktikës në shkollë.
- Mësimi praktik në shkollë synon të zhvillojë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet e domosdoshme për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të lartë. Këtu përfshihen idejimi, ndërtimi dhe zbatimi i strategjive e teknikave për mësimdhënie, vlerësim dhe organizim në nivel klase si dhe ndërtimi e përdorimi i mjeteve tekstuale, teknologjike e fizike për zhvillimin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Poshtu, këtu nënkuptohet edhe zhvillimi i aftësive për planifikim bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare.

## **HULUMTIMI I VEPRIMIT**

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim nga kimia si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës për



praktikat bashkëkohore të mësimdhënies në përgjithësi dhe atyre që bazohen në edukimin nga kimia në veçanti, do të shërbejnë jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënien dhe të nxëniet por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim. Theksi vihet në atë se si hulumtimi mund të bëhet një mjet jetik dhe i rëndësishëm për mësimdhënësit dhe udhëheqësit arsimorë për të lehtësuar të nxëniet e nxënësve dhe në veçanti për të përmirësuar praktikat mësimore që bazohen në qasjen e mësimdhënies në kimi.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

#### **Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si

dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyrë e Mësimit praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimit praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimit praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimdhënien duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësisë mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.
- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënësit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënësit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
  1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.

9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtuftjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 6. SPECIALIZIMI NË BIOLOGJI

### 6.1. Qëllimi i Specializimit

Specializimi Biologji, në programin Master i Mësimdhënies Lëndore, si program ndërdisiplinar i studimeve pasuniversitare të organizuara në Universitetin e Prishtinës, është i projektuar për studentët të cilët janë të interesuar për t'u përgatitur për mësimdhënie në lëndën e biologjisë. Qëllimi i tij është që të ofrojë arsim të qëndrueshëm dhe zhvillimi profesional për mësimdhënësit e lëndës së biologjisë. Në këtë kontekst, programi ofron edukim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi, si dhe në lëndën e biologjisë në veçanti. Studentët do të marrin njohuri kryesore nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore në lëndën e biologjisë, do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, si dhe kompetencat e tyre në këtë aspekt. Gjithashtu, atyre iu ofrohen mundësi që të zgjedhin kurse të ndryshme (zgjedhore) sipas preferencave dhe interesave personale, të cilat janë të ofruara në kuadër të këtij programi të studimit.

### 6.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Të krijojnë mjedis të përshtatshëm të të nxënit për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
2. Të zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të burimeve të të mësuarit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë.
3. Të zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh.: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta ( përfshirë nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.

4. Të demonstrojnë të kuptuarit dhe aftësi për planifikim, zbatim dhe vlerësim efektiv të përmbajtjeve nga biologjia, nëpërmjet zbatimit të strategjive të mësimdhënies me nxënësin në qendër, si dhe të nxënies biologjike në klasë, në laborator dhe në natyrë (outdoor learning).
5. Të reflektojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë teorinë, metodologjinë dhe praktikën e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënies së biologjike në veçanti.
6. Të analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme biologjike (biologji bimë, animale dhe humane) dhe në mënyrë efektive të arsyetojnë, komunikojnë dhe zbatojnë idetë në praktikën mësimore dhe fenomenet nga jeta e përditshme dhe fushat tjera lëndore.
7. Të zotërojnë aftësi për të modeluar, formuluar dhe për të zgjidhur probleme nga fusha e biologjisë, duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre.
8. Të demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në funksion të mirëqenies së të gjithë nxënësve, zhvillimit të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend.
9. Të shqyrtojnë ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikave arsimore të vendit, duke reflektuar për praktikën e tyre personale dhe zhvillimin e tyre profesional.

### 6.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË BIOLOGJI					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	6 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E BIOLOGJISË I	3	2	6 ECTS
5.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË MENDIMIT BIOLOGJIK TË NXËNIT INTERDISCIPLINAR NË BIOLOGJI	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E BIOLOGJISË II	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR	2	0	4 ECTS
		UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM ETIKA E MESIMDHENESIT			
6.	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI EDUKIMI PËR STEAM	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri III			Orë/javë		
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM	3	0	4 ECTS

		INKLUZIV			
3.	O	TË NXËNIT PËRMES EKSPERIMENTEVE NË BIOLOGJI	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE STATISTIKA NË ARSIM	2	0	4 ECTS
7.	Z	TË NXËNIT E BIOLOGJISË NË NATYRË TRASHËGIMIA NATYRORE DHE ZONAT E MBROJTURA VLERËSIMI DHE REFLEKTIMI NE MESIMIN NGA BIOLOGJIA	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
<b>Semestri IV</b>					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS



## 6.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES SË BIOLOGJISË I**

Fokusi i këtij kursi është që studentët-mësimdhënës të pajisen me njohuri shkencore dhe shkathtësi rreth përdorimit të strategjive, metodave dhe teknikave themelore të mësimdhënies për të arritur rezultatet e të nxënit të planifikuara në lëndët biologjike në nivelin e arsimit të mesëm të ultë dhe të lartë. Kursi i ndihmon studentëve-mësimdhënës të ardhshëm që të marrin njohuritë e nevojshme mbi kompetencat (njohuritë dhe shkathtësitë) për mësimdhënien e biologjisë në nivelet e ndryshme kurrikulare të sistemit kombëtar arsimor. Zbatimi i teknikave, metodave dhe strategjive bashkëkohore që trajtohen do të reflektojnë dhe avancojnë praktikën e mësimdhënies në biologji. Studentët do të zotërojnë në mënyrë analitike njohuritë bazë të metodave apo strategjive të mësimdhënies dhe do të japin vlerësim mbi këto metoda.

#### **HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË MENDIMIT BIOLOGJIK**

Kursi fokusohet në historikun dhe zhvillimin e shkencës së biologjise, diciplinave kryesore të saj, dhe rolin e saj në zhvillimin e të shoqërisë. Kursi shqyrton tema të historisë së biologjise deri në ditët e sotme përfshirë analiza filozofike të këtyre zhvillimeve. Studentët do të kuptojnë se si biologët e së kaluarës kanë menduar dhe punuar për zhvillimet biologjike, dhe si kanë përdorur teori të reja dhe metoda praktike. Kursi është i dizajnuar për të zhvilluar aftësinë e studentit për të kuptuar kthesat historike në shkencat biologjike, dhe për të aplikuar idetë shkencore për përshkrimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike në biologji.

#### **TË NXËNIT INTERDISCIPLINAR NË BIOLOGJI**

Ky kurs ka për studim parimet moderne të ndërveprimit mes shkencave të biologjise, kimise, fizikes, gjeografise, matematikes, mjekesise e teknologjise. Të gjitha këto njohuri janë të integruara në disiplina të përbashkëta si: biokimi, biogjeografi, biofizike, bioteknologji, biomjekesi e modelime matematikore në biologji. Ky kurs përshkruan shembuj ilustrativ të interdisiplinaritetit në kuadër të botes së gjallë. Qëllimi i këtij kursi është që studentet t'i përvetesojnë konceptet themelore mbi mesimin e integruar apo interdisiplinar si koncept i kornizës kurrikulare.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I**

Mësimi praktik përfshinë dy komponentë të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimsdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimsdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES SË BIOLOGJISË II**

Kursi ofron për studentët të kuptuarit e qasjeve dhe planifikimit të mësimsdhënies në lëndën e biologjisë duke aplikuar teori të ndryshme kurrikulare të të nxënies dhe mësimsdhënies.

## **EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM**

Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës Kurrikulare si çështje ndërkurrikulare që nga viti 2016. Studentimësimsdhënës me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socioekonomik si dhe rolin e edukimit të gjeneratave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.

## **EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI**

Në këtë kurs arrihet përvetësimi i koncepteve bazë të njohurive të avancuara të këshillimit individual në ndërmarrësi. Jepen burime të ndryshme të informacioneve për mundësitë dhe drejtimit e ndryshme të arsimit dhe fusha të mundshme të punësimit, si; arsim profesional, drejtime në lëndët ekzakte, drejtime teknike, drejtime mjekësore, mjedisore e mediatike. Shtjellohet ndikimi i faktorëve të ndryshëm si; familja, rrethi shoqëror, tregu i punës, institucioni shkollor dhe

ndikues të tjerë të mundshëm, që ndihmojnë në edukimin e nxënësve në ndërmarrësi.

### **TË NXËNIT PËRMES EKSPERIMENTEVE NË BIOLOGJI**

Studentët do të aftësohen dhe specializohen për punët laboratorike dhe eksperimentale në të nxënit e biologjisë. Ata do të përdorin lloje të ndryshme të mikroskopave, mikrotom. Do të punojnë preparate histologjike dhe citologjike si dhe ngjyrosjen e tyre. Biotestet në baktere, parashtazorë, fitoplanktonë e bimë të larta. Përcaktimin dhe numërimin e elementeve të gjakut. Eksperimentet me *Drosophila*-n e ndërtimin e kariotipit human.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundur nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimin praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **TË NXËNIT E BIOLOGJISË NË NATYRË**

Përmes këtij kursi studentët do të organizojnë forma të ndryshme të organizimit të orëve të biologjisë në natyrë. Studentët do të njoftohen me teknikat e të nxënit të lëndës së biologjisë nga burimet primare të informacionit siç janë: natyra, muzetë e natyrës, kopshtet zoologjike e botanike. Do të analizohet roli i ekskursioneve, kampingjeve verore dhe dimërore në të nxënit e biologjisë. Roli i vëzhgimit të botës së gjallë në natyrë si dhe monitoringut të ujit, ajrit e tokës si dhe indikatorët biologjik në lidhje me ndotjen e ujit, ajrit e tokës.

### **TRASHËGIMIA NATYRORE DHE ZONAT E MBROJTURA**

Kursi është një nga disiplinat përmes të cilëve studentët do të fitoj njohuritë bashkëkohore mbi trashëgiminë natyrore që koncentrohet brenda zonave të mbrojtura natyrore por edhe jasht tyre dhe vlerat edukative të tyre. Në këtë kurs studentët do fitojnë njohuritë mbi konceptin e zonave të mbrojtura natyrore, kategoritë ndërkombëtare dhe kombëtare të zonave të mbrojtura, përfitimet ekonomike, turistike, shkencore, edukative dhe rekreative nga zonat e mbrojtura, konventat ndërkombëtare dhe ligjet për mbrojtjen e natyrës, zonat e mbrojtura ndërkufitare dhe rrjetin e trashëgimise natyrore në Kosovë.

### **VLERËSIMI DHE REFLEKTIMI NË TË NXËNIT E BIOLOGJISË**

Do të studiohen mënyrat e përcjelljes, vlerësimit dhe reflektimit të njohurive në biologji. Analizohen kriteret e notimit për përvetësimin e përmbajtjeve arsimore, notat përshkruese për punimet me shkrim, notimi i përgjigjeve me gojë. Vëmendje e veçantë i kushtohet vlerësimit me bazë kurrikulen.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Praktika pedagogjike III përfshinë dy komponente të lidhura ngushtë. Pjesën teorike dhe reflektive në kampus dhe pjesën e mësimit praktike në shkollë.

- Pjesa e kursit e zhvilluar në kampus, pra, ka dy qëllime kryesore: (1) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në praktikë në shkollë; (2) t'u ofrojë studentëve mundësi, kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim të praktikës në shkollë.
- Mësimi praktik në shkollë synon të zhvillojë njohuritë, aftësitë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e domosdoshme për të qenë mësime në nivelin e shkollës së mesme të lartë. Këtu përfshihen idejimi, ndërtimi dhe zbatimi i strategjive e teknikave për mësimdhënie, vlerësim dhe organizim në nivel klase si dhe ndërtimi e përdorimi i mjeteve tekstuale, teknologjike e fizike për zhvillimin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Poshtu, këtu nënkuptohet edhe zhvillimi i aftësive për planifikim bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor

dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturave nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

**Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyrë e Mësimit praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimit praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimit praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimdhënien duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.
- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënësit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënësit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

10. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.
  1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
11. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.

12. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
13. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
14. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentit regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
15. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
16. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
17. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
18. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 7. SPECIALIZIMI NË HISTORI

### 7.1. Qëllimi i Specializimit

Specializimi Histori, në programin Master i Mësimdhënies Lëndore, si është program ndërdisiplinar i studimeve pasuniversitare të organizuara në Universitetin e Prishtinës, i projektuar për studentët që janë të interesuar për t'u përgatitur për mësimdhënie në lëndën e historisë. Qëllimi i tij, është ofrimi i arsimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve të lëndës së historisë. Në këtë kontekst, programi ofron edukim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi si dhe në lëndën e historisë në veçanti. Studentët do të marrin njohuri kryesore nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore në lëndën e historisë, do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë si dhe kompetencat e tyre në këtë aspekt. Gjithashtu, atyre iu ofrohen mundësi që të zgjedhin kurse të ndryshme (zgjedhore) sipas preferencave dhe interesave personale, të cilat janë të ofruara në kuadër të këtij programi të studimit.

### 7.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimet në fushën e edukimit.
2. Krijojnë mjedis të përshtatshëm të nxënies për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
3. Zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të burimeve të të mësuarit, duke



përfshirë përdorimin e teknologjisë.

4. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta (përfshirë nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
5. Analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjet mësimore, qoftë nga historia kombëtare apo nga ajo ndërkombëtare, duke shfrytëzuar strategji të reja të mësimdhënies në lëndën e historisë.
6. Shqyrtojnë, analizojnë dhe vlerësojnë teoritë, metodat dhe praktikat e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënien e historisë dhe të edukatës qytetare në veçanti, si dhe reflektojnë për praktikat e tyre personale.
7. Analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme të historisë, fenomenet nga jeta e përditshme, ngjarjet më të njohura në historinë e njerëzimit si dhe raportet e historisë dhe të edukatës qytetare me shkencat e tjera shoqërore.
8. Zotërojnë aftësi për të identifikuar probleme të natyrës historike me të cilat ballafaqohet shoqëria si dhe kontribuojnë në evitimin e problemeve të ndryshme nga fusha e historisë, duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre.
9. Demonstron aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin në përgjithësi gjithnjë në funksion të mirëqenies të të gjithë nxënësve, zhvillimit të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend.
10. Shqyrtojnë, komunikojnë dhe i zbatojnë metodat dhe teknikat e reja në mësimdhënien e historisë dhe edukatës qytetare, si dhe reflektojnë lidhur me ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikat arsimore të vendit dhe ndikimin e tyre në mësimdhënien dhe të nxënësve në lëndën e historisë si dhe në atë të edukatës qytetare.

### 7.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË HISTORI					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	6 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E HISTORISË I	3	2	6 ECTS
5.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	KAPITUJ TË ZGJEDHUR NGA HISTORIA E QYTETËRIMEVE TË LASHTA QYTETËRIM SHQIPTAR	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E HISTORISË II	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR STILET E UDHEHEQJES NE ARSIM EDUKIMI PËR STEAM ETIKA E MESIMDHENESIT	2	0	4 ECTS
6.	Z	HARMONIA SOCIALE DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE MËSIMDHËNIA PËR HISTORINË E RELIGJIONEVE GJEOGRAFI KOMBËTARE	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Viti II					

Semestri III			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV	3	0	4 ECTS
3.	O	HISTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS SHQIPTARE	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TE QËNDRUESHËM TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM MEDIAT NE MESIMDHENIEN E HISTORISE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	0	4 ECTS
7.	Z	EDUKIMI PËR TRASHËGIMI KULTURORE STATISTIKA NË ARSIM ILIRËT, JETA, KULTURA, BESIMI DHE ZAKONET MËSIMDHËNIA PËR EDUKATË QYTETARE	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
Semestri IV					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 7.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E HISTORISË I

Ky kurs është përqëndruar në diskutimin e temave me rëndësi të veçantë për përgatitjen e mësimeve të historisë. Temat përfshijnë mësimeve të historisë në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, konceptet bazë që kanë të bëjnë me mësimeve dhe të nxënies, mësimeve të historisë në linjë të drejtë me kërkesat e kurrikulës, përgatitjen e orës mësimore dhe pjesët e saj, qasje teorike dhe metodologjike të mësimeve të historisë, kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënies në lëndën e historisë, format dhe metodat në mësimeve të historisë, qasje alternative të mësimeve, mjetet mësimore, motivimi në mësimeve të historisë, përkufizimet dhe teoritë e motivimit, puna me burime historike, etj.

#### KAPITUL TË ZGJEDHUR NGA HISTORIA E QYTETËRIMEVE TË LASHTA

Ky kurs, në mënyrë krahasuese, diakronike dhe sinkronike, ndjek zhvillimin historik të disa qytetërimeve të lashta, të tilla si Egjipti, Mesopotamia, Siria, Irani, Kreto-Mikena, Greqia, Roma dhe Iliria. Përveç kësaj, kursi merr në konsideratë qasje të ndryshme metodologjike, modele teorike dhe interpretime të burimeve të ndryshme letrare dhe arkeologjike.

#### QYTETËRIM SHQIPTAR

Ky kurs fokusohet në qytetërimin shqiptar, zhvillimin e tij nëpër etapat historike, ndikimet e jashtme, ndikimet religjioze dhe transformimet e brendshme të qytetërimit shqiptar. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: krijimi i qytetërimit shqiptar, ndikimet e jashtme, qytetërimi ilir, qytetërimi arbëror, qytetërimi shqiptar dhe krishterizmi, qytetërimi shqiptar dhe islamizmi, qytetërimi shqiptar dhe krijimi i shtetit kombëtar shqiptar, qytetërimi shqiptar përball integriteteve ndërkombëtare dhe globalizmit. Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e qytetërimit shqiptar dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimeve dhe të nxënies.

#### PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I

Mësimi praktik përfshinë dy komponentë të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimgdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimgdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E HISTORISË II**

Ky kurs ofron njohuri lidhur me mësimgdhënien dhe të nxënit në lëndën e historisë. Temat që shtjellohen në këtë kurs kanë të bëjnë me konceptet themelore të mësimgdhënies dhe të të nxënit në përgjithësi si dhe me konceptet që kanë të bëjnë me historinë, në veçanti. Kursi shtjellon edhe rolin e koncepteve historike në ndërtimin e shpjegimeve dhe rrëfimeve historiografike, parimet themelore, strategjitë, metodat, teknikat në mësimgdhënien dhe të nxënit e historisë, inpreimin në lëndën e historisë, multiperspektivitetin, të mësuarit konceptual në mësimgdhënien e lëndës së historisë, mësimgdhënien e historisë dhe të mendurit kritik, strategjitë për zhvillimin e të menduarit kritik. Gjithashtu, të nxënit e mësimit të historisë, faktorët psikologjik, faktorët didaktikë për riprodhimin e përmbajtjeve historike, strategjitë e të nxënit dhe të mbajturit mend, bërja e metodave historike si dhe metodat e kërkimit dhe të zbulimit në mësimin e historisë, perspektiva sociokulturore dhe konteksti i të mësuarit historik, janë tema që trajtohen në këtë kurs.

### **STILET E UDHËHEQJES NË ARSIM**

Ky kurs synon t'i pajisë pjesëmarrësit me një kuptim gjithëpërfshirës të teorive dhe stileve të menaxhimit në arsim, duke i përgatitur ata për të qenë udhëheqës efektivë në mjediset arsimore. Nëpërmjet një kombinimi të diskutimeve teorike, zbatimeve praktike dhe studimeve të rasteve, studentët do të fitojnë njohuri të vlefshme për natyrën komplekse dhe dinamike të menaxhimit arsimor. Kursi është krijuar për të ofruar një eksplorim të thellë të teorive dhe stileve të ndryshme të

menaxhimit në fushën e arsimit. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë konceptet, parimet dhe praktikat kryesore që lidhen me menaxhimin arsimor, me fokus në të kuptuarit se si teoritë dhe stilet e ndryshme ndikojnë në efektivitetin organizativ, udhëheqjen, performancën e stafit arsimor dhe rezultatet e nxënësve.

### **HARMONIA SOCIALE DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE**

Ky kurs është krijuar për të mundësuar rishikimin e këndvështrimeve teorike dhe praktike, që kanë të bëjnë me harmoninë sociale dhe zgjidhjen e konflikteve. Kursi fokusohet në çështjet kyçe që lidhen me krijimin e komunitetit, komunikimin, përcaktimin e konfliktit, stilet e zgjidhjes së konfliktit, emocionet në konflikt, strategjitë e zgjidhjes së problemeve përmes bashkëpunimit, analizën e konfliktit dhe ekspozimin e fuqisë në konflikt, ngacmimin dhe ndërmjetësimin. Lënda përfshin edhe tema të tjera të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me rolin e edukimit në promovimin e harmonisë sociale dhe zgjidhjes së konflikteve të natyrave të ndryshme.

### **MËSIMDHËNIA PËR HISTORINË E RELIGJIONEVE**

Ky kurs trajton temat që kanë të bëjnë jo vetëm me historinë e religjioneve por edhe me mësimdhënien për religjionin. Temat kryesore që përfshihen në këtë kurs fokusohen në përdorimin e metodave, strategjive si dhe teknikave bashkëkohore të mësimdhënies, në mësimdhënien e religjioneve politeiste (egjiptase, greke, romake dhe ilire) dhe monoteiste (judaizmi, krishterimi dhe islami). Gjithashtu, roli i edukimit në bashkëjetesën paqësore dhe tolerancën fetare midis religjioneve të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme historike, janë pjesë përbërëse e diskutimeve dhe debateve që do të zhvillohen me studentë në kuadër të këtij kursi.

### **GJEOGRAFIA KOMBËTARE**

Gjeografia kombëtare është një disiplinë akademike që studion trojet shqiptare, veçoritë fizikogjeografike, shoqërore-ekonomike si dhe pasuritë natyrore të tyre. Në kurs trajtohet e kaluara e kombit shqiptar dhe faktorët që ndikuan në copëtimin e trojeve shqiptare. Gjithashtu, në këtë kurs trajtohen edhe çështje që kanë të bëjnë me popullsinë, karakteristikat demografike, vendbanimet si dhe ekonominë e trevave shqiptare. Trajtimi kompleks i kësaj lënde ofron njohuri për gjeografinë, historinë, demografinë dhe ekonominë e trevave shqiptare, si dhe edukimin e studentëve me dashurinë për kombin shqiptar dhe vlerat natyrore e kulturore të tij.

## **HISTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS SHQIPTARE**

Kjo lëndë paraqet origjinën dhe zhvillimin e popullit shqiptar brenda trojeve autoktone shqiptare. Esenca kryesore do të mbështetet në prezentimin e historisë dhe të kulturës shqiptare në aspektin kronologjik dhe përbajtësor, nga ilirët e deri tek pavarësia e Kosovës. Historia dhe kultura shqiptare në ecejaket e tyre janë të lidhura ngushtë edhe me karakteristika tjera të cilat e kanë përshkruar popullin shqiptar gjatë historisë. Kursi përgadit studentët që të njohin kulturën dhe traditën e popullit shqiptarë dhe të njëjtat ti bartin dhe t'i kultivojnë tek nxënësit.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshinë dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë me njëra tjetrën: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe t'u ofrojë kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimgdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimgdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas plan programit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **MEDIA NË MËSIMDHËNIEN E HISTORISË**

Ky kurs shqyrton mundësitë aktuale dhe potenciale të shfrytëzimit të mediave në mësimgdhënie e historisë. Kursi do të strukturohet nga temat qendrore që përfshijnë, jo vetëm shfrytëzimin e medias në mësimgdhënie e historisë, por edhe mënyrën e analizës, interpretimit, si dhe prezantimit të medias së shkruar dhe digjitale, si burime historike në klasë. Gjithashtu, ky kurs përfshin aktivitete, sugjerime, këshilla dhe shpjegime për mësimgdhënësit lidhur me përdorimin e medias në mësimgdhënie e historisë. Gjithashtu, me anë të këtij kursi do të shqyrtojmë mënyrën se si shumë mësimgdhënës të lëndës së historisë e kanë transformuar mënyrën e mësimgdhënie së historisë dhe prezantimin e përmbajtjeve mësimore nga fusha e historisë përmes përdorimit të medias.

### **EDUKIMI PËR TRASHËGIMI KULTURORE**

Ky kurs është i fokusuar që studentëve t'iu ofroj njohuri për edukimin në raport me trashëgiminë kulturore si dhe ndikimin e tij në vlerësimin dhe ruajtjen e saj. Kursi ofron mundësi që studentët të marrin njohuri teorike për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me edukimin për ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Temat që përfshihen në këtë kurs përfshijnë konceptet themelore të trashëgimisë kulturore, edukimin për zhvillimin e politikave të trashëgimisë kulturore, edukimin për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, analizën, prezantimin dhe diskutimin e konventave të ndryshme që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, edukimin për promovimin e trashëgimisë kulturore, roli bashkëkohor i trashëgimisë materiale dhe jo-materiale; edukimin për menaxhimin e pronave kulturore si një vend modern. Kursi përfshin edhe vizita të monumenteve të trashëgimisë kulturore.

### **ILIRËT: JETA, KULTURA, BESIMI DHE ZAKONET**

Kjo lëndë ofron për studentët njohuri bazike për ilirët, historinë e tyre, jetën dhe kulturën. Në lëndë përfshihen historia diplomatike, gjuha, kultura materiale dhe shpirtërore (si prodhimtaria ilire, simbolet e kultit, doket, zakonet dhe religjionin) që nga Periudha e Hekurit e deri në përfundim të Antikës.

### **MËSIMDHËNIA E EDUKATËS QYTETARE**

Ky kurs përfshin tema, të cilat studentëve u ndihmojnë që të zhvillojnë njohuri dhe shkathtësi të zbatimit të strategjive bashkëkohore të mësimdhënies nga fusha e edukatës qytetare. Kursi ofron njohuri në zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, që kanë të bëjnë me konceptet themelore të edukatës qytetare, të drejtat e njeriut, të drejtat dhe përgjegjësitë, demokracinë dhe zhvillimin e saj në Kosovë, zgjedhjet, qeverisjen lokale, parlamentin, riciklimin, ndotjen e mjedisit, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, legjislacionin, gjykatat, dinjitetin njerëzor, racizmin.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Në kuadër të kursit Praktika Pedagogjike III, studentët do të zgjerojnë njohurit për strategjitë e mësimdhënies, proceset e të nxëniet, vëzhgimit të aktiviteteve në klasë në shkolla të mesme të larta. Fokusi i kursit Praktika Pedagogjike III, është në përgatitjen e studentëve për angazhim në secilin nga aktivitetet e klasës, studentët duhet të planifikojnë dhe reflektojnë në ditarët e tyre për aktivitetet në shkollë



duke u përgatitur për mësimdhënës efektiv i së ardhmes, duke përdorur TIK-un dhe realizimin e arsimit gjithëpërfshirës.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

#### **Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën

mentorimin e mësimeve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe në mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimi praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimeve dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimi praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimi praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimeve duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimi praktik, studentët do të mbajnë shënime dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimeve në praktikën pedagogjike në mënyrë elektronike.
- Ditarin e studentit mësimeve: Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënësit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënësit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

## **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të

procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kriteret:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman.  
1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentit regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 8. SPECIALIZIMI NË GJEOGRAFI

### 8.1. Qëllimi i Specializimit

Specializimi Gjeografi, në programin Master i Mësimdhënies Lëndore, si program ndërdisiplinar i studimeve pasuniversitare të organizuara në Universitetin e Prishtinës, është i projektuar për studentët që janë të interesuar për t'u përgatitur për mësimdhënie në lëndën e gjeografisë. Qëllimi i tij, është që të ofrojë arsim të qëndrueshëm dhe zhvillimin profesional për mësimdhënësit e lëndës së gjeografisë. Në këtë kontekst, programi ofron edukim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi, si dhe në lëndën e gjeografisë në veçanti. Studentët do të marrin njohuri kryesore nga fusha e mësimdhënies bashkëkohore në lëndën e gjeografisë, do të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë si dhe kompetencat e tyre në këtë aspekt. Gjithashtu, atyre iu ofrohen mundësi që të zgjedhin kurse të ndryshme (zgjedhore) sipas preferencave dhe interesave personale, të cilat janë të ofruara në kuadër të këtij programi të studimit.

### 8.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimet në fushën e edukimit.
2. Krijojnë mjedis të përshtatshëm të të nxëniet për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
3. Zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të

teorive të ndryshme të mësuarit dhe të burimeve të të mësuarit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë.

4. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta ( përfshirë nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
5. Analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjet mësimore, qoftë nga gjeografia kombëtare apo nga ajo ndërkombëtare, duke shfrytëzuar strategji të reja të mësimdhënies në lëndën e gjeografisë.
6. Shqyrtojnë, analizojnë dhe vlerësojnë teoritë, metodat dhe praktikat e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënien e gjeografisë dhe të edukatës qytetare në veçanti si dhe reflektojnë për praktikat e tyre personale.
7. Analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme të gjeografisë, fenomenet nga jeta e përditshme si dhe raportet e gjeografisë dhe të edukatës qytetare me shkencat e tjera shoqërore.
8. Zotërojnë aftësi për të identifikuar probleme studimore në fushën e gjeografisë me të cilat ballafaqohet shoqëria si dhe kontribuojnë në zgjidhjen e tyre.
9. Demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin në përgjithësi gjithnjë në funksion të mirëqenies të të gjithë nxënësve, zhvillimit të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend.
10. Shqyrtojnë, komunikojnë dhe i zbatojnë metodat dhe teknikat e reja në mësimdhënien e gjeografisë dhe edukatës qytetare si dhe reflektojnë lidhur me ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikat arsimore të vendit dhe ndikimin e tyre në mësimdhënien dhe të nxënësve në lëndën e gjeografisë si dhe në atë të edukatës qytetare.

### 8.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË GJEOGRAFI					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	6 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË I	3	2	6 ECTS
5.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	ASPEKTI I BASHKËVEPRIMIT NJERI-NATYRË MËSIMI KABINETIK DHE PUNA NË TERREN	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË ARSIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË II	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR ETIKA E MËSIMDHËNËSIT UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	SHFRYTËZIMI I GIS DHE PLATËFORMAVE GJEOHAPËSINORE NË MËSIMDHËNIEN E GJEOGRAFISË LËVIZJA HAPËSINORE E POPULLSISË QYTETËRIMI SHQIPTAR	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS
Viti II					

Semestri III			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV	3	0	4 ECTS
3.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË REGJIONALE	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE STATISTIKA NË ARSIM	2	0	4 ECTS
7.	Z	GJEOGRAFIA KOMBËTARE GJEOTRASHËGIMIA DHE MJEDISI EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EDUKIMI PËR STEAM	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
Semestri IV					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 8.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË I**

Kursi pajisë studentët me njohuri nga metodat dhe strategjitë e mësimdhënies në fushën e gjeografisë. Trajton tema dhe çështje pedagogjike që kanë të bëjnë me mësimin e fushës së gjeografisë, duke krijuar mundësi aktive të nxënit produktiv, dhe duke ndryshuar rrënjësisht në aspektin perspektiv mësimdhënien dhe të nxënit e lëndës së gjeografisë. Përshtatja dhe aplikimi i metodave adekuate, si dhe përdorimi i mjeteve të konkretizimit për interpretimin e njohurive nga fusha e gjeografisë, do të ju ofroj studentëve një kuptim më të thellë për rolin dhe rëndësinë e mësimdhënies së kësaj disipline. Gjithashtu, ofrohen përmbajtje dhe aktivitete praktike nga planifikimi i punës mësimore në gjeografisë dhe vlerësimi e llojet e tij.

#### **ASPEKTI I BASHKËVEPRIMIT NJERI NATYRË**

Me anë të këtij kursi studentëve ju ofrohen njohuri për bashkëveprimin e ndërsjellë në mes të sistemeve natyrore e humane si dhe për efektet që janë rezultat i këtij bashkëveprimi. Në kurs trajtohen tema për Tokën si sistem dinamik, gjeosferat, vetit dhe relacionet mes tyre, energjinë dhe burimet e saj, sistemet natyrore e humane si dhe tipet e tyre, bashkëveprimi njeri-mjedis dhe efektet e tij, ndikimin e proceseve humane në rreziqet natyrore dhe ngrohjen globale si dhe vlerësimi i ndikimit të njeriut në mjedis.

#### **MËSIMI KABINETIK DHE PUNA NE TERREN**

Kursi mësimi kabinetik dhe puna në terren përmban njohuri lidhur me organizimin dhe mbajtjen e mësimin në kabinete dhe organizimin e ekspeditave në terren, format e ekspeditave dhe qëllimet e tyre. Puna në terren është pjesë e patjetërsueshme e mësimdhënies dhe e mësimin në gjeografi. Shikuar nga përmbajtja e gjeografisë terreni mbetet laborator i vërtetë për eksperimente gjeografike. Shumë çështje tematike në mjedis lokale si përdorimi i tokës bujqësore, problemet urbane, mjedisore, shpërndarja e shërbimeve në hapësirat rurale, prerja e pyjeve, konservimi i natyrës, pastaj përdorimi i hartave dhe instrumenteve për të matur, regjistruar, e dokumentuar të dhëna mësohen në



kabinet mirëpo më së miri kuptohen gjatë punës në terren. Ky kurs do të ju ndihmoj studentëve të gjeografisë që njohurit e tyre të fituara ne kabinete ti konkretizojnë në terren.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË II**

Kursi pajisë studentët me njohuri nga metodat dhe strategjitë e mësimdhënies në fushën e gjeografisë. Kursi trajton tema dhe çështje pedagogjike që kanë të bëjnë me mësimin gjeografisë, duke krijuar mundësi aktive në të nxënit produktiv, dhe duke ndryshuar rrënjësisht në aspektin perspektiv mësimdhënien dhe të nxënit e lëndës së gjeografisë. Përshtatja dhe aplikimi i metodave adekuate, si dhe përdorimi i mjeteve të konkretizimit për interpretimin e njohurive nga fusha e gjeografisë, që kanë të bëjnë me atmosferën, hidrosferën, litosferën, biosferën, si dhe tema me përmbajtje demografike, sociale, ekonomike, politike e kulturore etj., do të ju ofroj studentëve një kuptim më të thellë për rolin dhe rëndësinë e mësimdhënies së kësaj disipline. Gjithashtu, në kuadër të kursit zhvillohen përmbajtje dhe aktivitete praktike, duke filluar nga planifikimi i punës mësimore të gjeografisë, demonstrimi, menaxhimi i klasës, vlerësimi etj.

### **SHFRYTËZIMI I GIS DHE PLATËFORMAVE GJEOPAPËSINORE NË MËSIMDHËNIENEGJEOGRAFISË**

Kursi pajisë studentët me njohuri për infrastrukturën teknike, softuerike, përgatitjen njerëzore dhe metodat e nevojshme që ndihmojnë për të përdorur të dhënat hapësinore si modele që mundësojnë mbledhjen, përpunimin, analizën dhe publikimin e të dhënave hapësinore. Gjithashtu ndihmon në paraqitjen e këtyre modeleve në harta tematike, topografike apo edhe për të ndërlidhur zhvillimin e dukurive të caktuara. Studentët mësojnë aplikimin e metodave të avancuara dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore në funksion të prezantimit të tyre në procesin e mësidhëdhënies dhe të nxënit në lëndën e gjeografisë si mundësi unike për të pasqyruar boten reale përmes teknologjisë informative (kompjuterëve).

### **LËVIZJA HAPËSINORE E POPULLSISË**

Lëvizja hapësinore e popullsisë synon t'i ofrojë studentëve njohuri gjeografike, demografike dhe statistikore mbi lëvizjen hapësinore të popullsisë në botë në përgjithësi dhe në Shqipëri dhe Kosovë në veçanti. Analizohen shkaqet (ekonomike, politike, sociale dhe mjedisore) e lëvizjes hapësinore të popullsisë,

shqyrtohen faktorët tërheqës dhe faktorët shtytës, pasojat e lëvizjeve hapësinore në aspektin ekonomik, shoqëror edhe urban. Njihen me funksionet e institucioneve botërore dhe kombëtare për menaxhimin e lëvizjeve hapësinore, analizohet legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe theksohet rëndësia e aplikimit të teknologjisë GIS për paraqitjen hartografike të drejtimeve të migrimit. Në këtë kurs po ashtu analizohen rendet e lëvizjeve hapësinore në të ardhmen, kundruar nga aspekti i globalizimit.

### **QYTETËRIM SHQIPTAR**

Ky kurs fokusohet në qytetërimin shqiptar, zhvillimin e tij nëpër etapat historike, ndikimet e jashtme, ndikimet religjioze dhe transformimet e brendshme të qytetërimin shqiptar. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: krijimi i qytetërimin shqiptar, ndikimet e jashtme, qytetërimi ilir, qytetërimi arbëror, qytetërimi shqiptar dhe krishterizmi, qytetërimi shqiptar dhe islamizmi, qytetërimi shqiptar dhe krijimi i shtetit kombëtar shqiptar, qytetërimi shqiptar përball integriteteve ndërkombëtare dhe globalizimit. Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e qytetërimin shqiptar dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënies.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJEOGRAFISË REGJIONALE**

Kursi pajis studentët me njohuri nga metodat dhe strategjitë e mësimdhënies në fushën e gjeografisë regjionale. Kursi trajton tema dhe çështje pedagogjike që kanë të bëjnë me mësimin e kësaj fushe të gjeografisë, duke krijuar mundësi aktive të nxënies produktiv, dhe duke ndryshuar rrënjësisht në aspektin perspektiv mësimdhënien dhe mësimnxënien e lëndës së gjeografisë regjionale. Përshtatja dhe aplikimi i metodave adekuate, si dhe përdorimi i mjeteve të konkretizimit për interpretimin e njohurive nga fusha e gjeografisë regjionale ( njohuri për Evropën, Azinë, Afrikën, Amerikën Veriore e Jugore, si dhe Australinë me Oqeanin), do të ju ofroj studentëve një kuptim më të thellë për rolin dhe rëndësinë e mësimdhënies së kësaj disipline. Gjithashtu, ofrohen përmbajtje dhe aktivitete praktike nga planifikimi i punës mësimore të gjeografisë regjionale dhe vlerësimi e llojet e tij.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë:

- Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.
- Mësimin praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **GJEOGRAFIA KOMBËTARE**

Gjeografia kombëtare synon të ofrojë njohuri të përgjithshme për shtrirjen e trojeve shqiptare, kufijtë dhe administrimin politik të tyre; veçoritë fiziko-gjeografike, shoqërore-ekonomike si dhe pasuritë natyrore të tyre. Në kurs trajtohet e kaluara e kombit shqiptar dhe faktorët që ndikuan në copëtimin e trojeve të tyre, karakteristikat demografike, vendbanimet, dhe zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare. Trajtimi kompleks i kësaj lënde ofron njohuri për gjeografinë, historinë, demografinë e ekonominë e trevave shqiptare, si dhe edukimin e studentëve me dashuri për kombin shqiptar dhe vlerat natyrore e kulturore të tij.

### **GJEOTRASHËGIMIA DHE MJEDISI**

Përmes kursit Gjeotrashëgimia natyrore dhe mjedisi studentëve ju ofrohen njohuri shkencore, teknike dhe ligjore mbi trashëgiminë natyrore, trashëgiminë natyrore kombëtare dhe botërore, rolin dhe rëndësinë e saj përballë problemeve mjedisore lokale e rajonale, me origjinë humane dhe natyrore. Në kurs përfshihen kuptimet për zonat e mbrojtura sipas klasifikimit të IUCN-së, për institucionet botërore dhe kombëtare për menaxhimin e tyre, legjisllacionin kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe ndihmesa e aplikimit të teknologjisë GIS për katalogimin e gjeotrashëgimisë natyrore, roli dhe rëndësia e saj për ruajtjen e mjedisit.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Ne kuadër të kursit studentet do fitojnë njohuri se si të jenë aktiv në realizimin e objektivave të kutikulës bërthamë 3. Përdorin metodologji dhe teknika

bashkëkohore mësimore të aplikueshme për mësimin e gjeografisë. Trajtohen tema dhe çështje pedagogjike që kanë të bëjnë me mësimin e fushës, duke krijuar mundësi aktive të nxënit produktiv, dhe duke ndryshuar rrënjësisht në aspektin perspektiv mësimdhënien dhe të nxënit e lëndës së gjeografisë. Përshtatja dhe aplikimi i metodave adekuate, si dhe përdorimi i mjeteve të konkretizimit për interpretimin e njohurive nga fusha e gjeografisë, do të ju ofroj studentëve një kuptim më të thellë për rolin pedagogjik të mësimdhënies së kësaj disipline. Gjithashtu, eksplorohen mënyrat se si te motivohen nxënësit, të behet vetëvlerësimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm. Po ashtu do te analizohen mënyrat se si duhet mbajtur ditarët reflektues. Kursi përmban edhe informacione mbi aftësimin teknik te studenteve (krijimi dhe shfrytëzimi i mjeteve mësimore). Pastaj do te studiohen mënyrat e asistimit në aktivitetet e mësimdhënies. Do te elaborohen strategjitë e përdorura te mësimdhënies, proceset e te nxënit dhe vëzhgimit te aktiviteteteve në klase.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimit praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimit praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

#### **Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa,

dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimi praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimi praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimi praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimi praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimdhënien duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimi praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.
- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar

dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman. 1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studentin në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiutit varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentin regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.

8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 9. SPECIALIZIMI NË TEKNOLOGJI DHE TIK

### 9.1. Qëllimi i Specializimit

Specializimi Mesimdhënia në Teknologji dhe TIK ofrohet në programin Master i Mësimdhënies Lëndore. Ky program i studimeve korrespondon me fushën kurrikulare “Jeta dhe puna” të kurrikulës së re të Kosovës. Në nivelin parauniversitar lënda kurrikulare për klasët VI-IX është Teknologji me TIK dhe lënda kurrikulare për klasën X-XII është Teknologji e Informimit dhe Komunikimit (TIK). Konceptet kryesore të fushës kurrikulare “Jeta dhe puna” që realizohen nëpërmjet këtyre lëndëve kurrikulare janë: Teknologji duke përfshirë TIK-un (klasat VI-IX), Puna dhe edukimi për ndërmarrësi (klasat VI-IX), Këshillim dhe orientim në karrierë (klasat VI- IX), Edukimi dhe zhvillim të qëndrueshem (klasat VI-IX) dhe Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK (klasat X-XII). Studentët e diplomuar në programin bachelor, Teknologji - Informatikë të Fakultetit të Edukimit quheshin të kualifikuar për mësimdhënie të Teknologjisë dhe TIK-ut në shkollën e mesme të ulët (klasat VI-IX). Me akreditimin e programit MA mësimdhënës i Teknologjisë dhe TIK (60 ECTS) janë kualifikuar edhe për shkollën e mesme të lartë (klasat X-XII). Prezenca e theksuar e përmbajtjeve nga fusha e TIK-ut, sidomos në arsimin e mesëm të lartë, imponon nevojën që për mësimdhënës të Teknologjisë dhe TIK-ut për klasët VI- XII të përgatiten persona që kanë njohuri të thellë të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Njëkohësisht, ata duhet të pajisen edhe me njohuri relevante nga teknologjia, edukimi për ndërmarrësi, këshillimi e orientimi në karrierë si dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm që, në kushtet e Kosovës, pra kërkohet një program dyvjeçar.

### 9.2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e zhvillimit të



kurrikulës nëpërmjet angazhimit në aktivitetet profesionale dhe hulumtimet në fushën e edukimit.

2. Krijojnë mjedis të përshtatshëm të të nxëniet për të gjithë nxënësit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive pedagogjike dhe praktikës së mësimdhënies.
3. Zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të teorive të ndryshme të të mësuarit dhe të burimeve të të mësuarit në përdorimin e teknologjisë dhe TIK-ut.
4. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh: gjithëpërfshirja, nxënësit me nevoja të veçanta (përfshirë nxënësit e talentuar), aspektet gjinore, të shqyrtuara nga perspektiva të ndryshme.
5. Demonstrjnë të kuptuarit dhe aftësi për planifikim, zbatim dhe vlerësim efektiv të përmbajtjeve nga teknologjia dhe TIK-u, nëpërmjet zbatimit të strategjive të mësimdhënies me nxënësin në qendër, si dhe të nxëniet e teknologjisë dhe TIK-ut në klasë dhe në laborator.
6. Reflekojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë teoritë, metodologjitë dhe praktikat e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe mësimdhënies së teknologjisë dhe TIK-ut në veçanti.
7. Analizojnë lidhjen ndërmjet fushave të ndryshme të teknologjisë dhe TIK-ut dhe në mënyrë efektive arsyetojnë, komunikojnë dhe i zbatojnë idetë në praktikën mësimore dhe fenomenet nga jeta e përditshme dhe fushat e tjera lëndore.
8. Zotërojnë aftësi për të modeluar, formuluar dhe për të zgjidhur probleme nga fusha e teknologjisë dhe TIK-ut, duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre.
9. Demonstrjnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në funksion të mirëqenies të të gjithë nxënësve, zhvillimit të qëndrueshëm të shkollës dhe avancimit të arsimit në vend.
10. Shqyrtojnë ndërlidhjen e legjislacionit dhe politikave arsimore të vendit, duke reflektuar për praktikat e tyre personale dhe zhvillimin e tyre profesional.

### 9.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË TEKNOLOGJI DHE TIK					
Viti I					
Semestri I			Orë/javë		
		Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE E KURRIKULËS	3	0	4 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME	3	0	4 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E TIK-ut	2	0	4 ECTS
5.	O	VIZATIMI TEKNIK PËRMES SOFTVERËVE	3	0	5 ECTS
6.	Z	SHKRIM AKADEMIK KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
7.	Z	KËSHILLIMI NË KARRIERË EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI	2	0	4 ECTS
			18	2	30 ECTS
Semestri II					
1.	O	TEKNOLOGJI E MATERIALEVE TË AVANSUARA	2	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
3.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT ELEKTRONIK	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E TEKNOLOGJISË	3	0	5 ECTS
5.	O	KAPITUJ TË ZGJEDHUR NGA INXHINIERIA MEKANIKE	3	0	5 ECTS
6.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR ETIKA E MËSIMDHËNËSIT UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM	2	0	3 ECTS
7.	Z	E-BASHKËPUNIMI NË EDUKIM SHFRYTËZIMI I SOFTVERËVE DHE TEKNOLOGJIVE PËR MËSIMDHËNIE INTERAKTIVE STATISTIKA NË ARSIM	2	0	3 ECTS
			18	0	30 ECTS
Viti II					

Semestri III			Orë/javë		
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	2	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIM INKLUZIV	2	0	4 ECTS
3.	O	CLOUD COMPUTING NË EDUKIM	2	0	4 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	4 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	O	BURIMET E RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË	2	0	4 ECTS
7.	Z	PSIKOLOGJIA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	0	3 ECTS
8.	Z	PAJISJET TEKNIKE EFICIENCA E ENERGJISË EDUKIMI PËR ZHVILLIM TE QËNDRUESHËM VLERËSIMI DHE TË NXËNIT NË TEKNOLOGJI DHE TIK	2	0	3 ECTS
			18	0	30 ECTS
Semestri IV					
1.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III	3	0	5 ECTS
2.	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3.	O	TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 9.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E TIK-UT**

Ky kurs fokusohet në mënyrat e planifikimit të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit nga lëmia e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: mësimdhënia ndërvepruese përmes përdorimit të metodave të të menduarit kritik, struktura e orës mësimore me praktika të suksesshme bashkëkohore, qëllimet dhe objektivat, si dhe mënyrat e metodat e vlerësimit sistematik. Studentët në mënyrë praktike do të ndërtojnë dhe zbatojnë modele për zhvillimin e mësimin në kushtet konkrete duke harmonizuar të gjitha fazat si: përgatitjen për të nxënë, përpunimin e përmbajtjes së caktuar dhe konsolidimin e të nxënit. Studentët në mënyrë analitike do të trajtojnë dhe zbatojnë metodat e mësimdhënies dhe të nxënit në kushtet konkrete të klasës konform planprogrameve përkatëse në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

#### **VIZATIMI TEKNIK PËRMES SOFTVERËVE**

Në këtë kurs studentët fitojnë njohuri dhe zbatojnë teknikat e vizatimit teknik, standardet, formatet, llojet dhe përdorimin e vijave, shkrimin teknik, rrafshet projektuese, projeksionin e pikës dhe drejtëzes, projeksionin ortogonal të trupave, paraqitjen e objekteve dhe detajet e ndryshme, prerjet, dimensionimin dhe kualitetin e përpunimit. Studentët mësojnë dhe zbatojnë rregullat themelore të vizatimit teknik me vegla për punë dore dhe realizojnë të njëjtat vizatime në kompjuter duke përdorur softuerët për vizatime në dy dimensionale dhe tredimensionale.

#### **KËSHILLIMI NË KARRIERË**

Në këtë lëndë mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe njohurive aktuale nga kjo fushë të re për këshillim në karrierë. Hulumtohen burime të ndryshme të informacioneve për këshillim dhe fusha të mundëshme të punësimit, si; arsimit, arsim profesional, drejtime në lëndët ekzakte, drejtime teknike, mjeksore, mjedisore e mediatike, në vend dhe jashtë vendi. Shtjellohen ndikimi i faktorëve të ndryshëm, si familja, rrethi shoqëror dhe ndikues të tjerë të mundshëm, që

ndikojnë dhe ndihmojnë në orientimin e individit në përzgjedhjen e drejtimeve të veqanta me perspektivë në karrierën e të rinjëve. Analizohet tregu aktual në drejtimet e shumta të ndryshme në vend dhe jashtë vendi. Analizohen epërsit dhe rreziqet gjatë orientimit në drejtime të ndryshme.

### **EDUKIMI NË NDËRMARRËSI**

Në këtë kurs mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i njohurive të avansuara në fushën e edukimit për aftësit e nxënësve në ndërmarrje, aktivitete individuale. Praktikohen aktivitete me studentë lidhur me pregaditjen e planeve individuale, familjare e grupe. Hulumtohen burime të ndryshme të informacioneve për ndërmarrje të ndryshme dhe zhvillimin e kreativitetit në ndërmarrësi. Shtjellohen ndikimi i faktorëve të ndryshëm të ndryshëm që nxizin dhe zhvillojnë vetitë dhe kreativitetin e studentëve për ndërmarrësi në jetë. Punime dhe projekte të ndryshme në aftësimin e përpilimit të planeve të biznesit familjar apo edhe të planeve për ide të ndryshme tjera profitpruese.

### **TEKNOLOGJIA E MATERIALEVE TË AVANSUARA**

Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja lidhur me kuptimin e teknologjisë së jometaleve dhe metaleve, si dhe zbatimin e tyre në teknologjitë bashkëkohore. Studentët do të njohin mirë vetitë e materialeve, si: vetitë fizike, kimike, teknike dhe teknologjike. Studentet do të avancojnë njohuritë mbi lëndët e para dhe procesin teknologjik të prodhimit të letrës, plastikës, qelqin, hekurin dhe lëgurat. Pastaj mësojnë për fibrat e karbonit, fibrat e qelqit, aerogjelet, smart materialet, nanotubat, si dhe zbatimin praktike të tyre në ndërtim të pjesëzave të ndryshme të pajisjeve si; kompjuterëve, llaptopëve, telefonave dhe mikropjesëve të tjera me rëndësi të veçantë për kompletimin e pajisjeve dhe efektet e tyre në zbatime praktike.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I**

Mësimi praktik përfshinë dy komponentë të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë

si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT ELEKTRONIK**

Ky kurs prezanton konceptet dhe metodat e avancuara në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit elektronik si dhe të edukimit në distancë nga pikëpamja e mbështetjes që ofron Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit për një formë të tillë të arsimit. Gjithashtu gjatë këtij kursi do të trajtohen modelet e për mësimdhënie dhe të nxënit elektronik, Teknologjitë e Internetit në edukimi, Simulimet kompjuterike dhe animacionet në edukim. Kursi ofron po ashtu njohuri për realizimin e eksperimenteve përmes kompjuterit, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga Kompjuteri, objektet e ripërdorshme të të mësuarit, Sistemet e Menaxhimit të të mësuarit (LMS).Gjatë kursit po ashtu do të trajtohen sistemet e adaptueshme të të mësuarit, problemet kompatible të aseteve të të mësuarit elektronik dhe veglave softëerike, biblioteka dixhitale, etj. Ky kurs po ashtu trajton vlerësimin Elektronike, mënyrat e krijimit të pyetësorëve elektronike në Internet, vlerësimin e cilësisë së materialeve të mësimit elektronik.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E TEKNOLOGJISË**

Kursi Mësimdhënia dhe të nxënit e teknologjisë fokusohet që studentët të mësojnë njohuritë mbi metodologjitë e mësimdhënjes dhe aplikimin praktik të metodologjive të mësimdhënies në shkolla të mesme të ulta dhe shkolla të mesme të larta në lëminë e teknologjisë. Temat përfshijnë komponentën e korrikulës shkollore në shkollat e mesme të ulta dhe në shkollat e mesme të larta (nga viti i VI deri në vitin e XII). Kursi përmban në vehte; planifikimin e orës mësimore, përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënjes së teknologjisë si dhe mënyrat bashkëkohore të vlerësimit të studentëve. Student do të zbatojnë dhe hartojnë modele për orë mësimore nga kaputij të ndryshëm të teknologjisë.

### **KAPITUJ TË ZGJEDHUR NGA INXHINERIA MEKANIKE**

Në këtë kurs studentët fitojnë njohuri nga bazat e inxhinierisë mekanike, ku përfshihen detale të ndryshme të makinave, transmetuesit e ndryshëm, makinat hidraulike, makinat termike dhe makinat pneumatike. Studentët fitojnë njohuri për

makinat e thjeshta, levat, rrafshin e pjerrët, pykat, vidhat, transmetuesit me rrota të dhëmbëzuara cilindrike, konike dhe hiperboloidale, transmetuesit dhe mekanizmat me gungë, me zingjirë, motorët me djegie të brendshme, motorët me piston, motorët rrotullues, motorët turboreaktivë dhe raketorë, paisjet pneumatike, llojet e pompave, turbinat hidraulike aktive dhe reaktive si dhe tipet dhe llojet e kaldajave. Poashtu realizohet aplikimi i softverëve për përmbajtje të caktura gjatë kursit.

#### **E-BASHKËPUNIMI NË EDUKIM**

Kursi synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri lidhur me konceptet e Ebashkëpunimit dhe llojet e E-bashkëpunimit për komunikim dhe punë me kolegë dhe nxënës. Kursi shtjellon nocionet e E-bashkëpunimit në mjedisin mësimor dhe sesi kjo formë e bashkëpunimit ndikonë në zhvillimin profesional të vetëmësimdhënësve por edhe në rezultatet e të nxënësve. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar : grupet e diskutimit, format e komunikimit sinkron siç janë chat dhe videokonferencat, format e komunikimit elektronik asinkron, burimet për e-bashkëpunim, ëbsitet bashkëpunuese, teknologjitë për bashkëpunim, etj.

#### **SOFTUERET DHE TEKNOLOGJITË MËSIMDHËNIE INTEREAKTIVE**

Ky kurs prezanton mënyrat e përdorimit të veglave softuerverike si dhe teknologjive modern për të bërë mësimdhënien interaktive, dhe krijimin e hapsirave për mësim interaktiv. Disa nga temat të cilat përfshihen në këtë kurs janë: Mësimdhënia interactive, të nxënësve interaktiv, Shfrytëzimi I tabelave Interaktive, teknologjitë modern të edukimit, Veglat e teknologjive modern te edukimit, sistemet e të nxënësve multimedil, Te nxënësve permes telefonit mobil (Mobile Learning), Mësimdhënia interaktive dhe strategjitë e të nxënësve, Libri Elektronik (E-Book),Libri interaktiv (I-book), shërbimet Cloud për mësimdhënie interactive,Shfrytëzimi i platformes Moodle dhe veglavetë saj, Ëëbsitet interaktive dhe Apps-ët për edukim, përdorimi i VR,përdorimi i AR, etj.

#### **CLOUD COMPUTING NË EDUKIM**

Ky kurs prezanton parimet themelore, teknologjinë, dhe zhvillimin aktual të Cloud Computing, llojet e cloud computing dhe format e përdorimit të cloud computing ne edukim. Gjithashtu gajtë këtij kursi do të parqiten parimet themelore të cloud computing, historia e teknologjisë,arkitektura e platformes cloud, dallimi ne mes

te cloud computing dhe Web 2.0. Gjatë zhvillimit të këtij kursi do të trajtohen mënyrat e krijimit të llogarive personale në GSU si një përdorues, vizitimi i GSU platformës së cloud computing (IBM). Teknologjitë bazë në cloud, Cloud si i zgjuar, përdorimi cloud computing në edukim. Kursi ofron po ashtu njohuri për udhëzimet për zgjedhjen dhe vendosjen e shërbimeve cloud, sistemet cloud computing të vendosura si: Google AppEngine, Google, Amazon EC2 dhe S3, Google Apps për Arsimin, shfrytëzimi i Google Meet web app, Google Docs dhe Google Sites.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundur nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimin praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **BURIMET E RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË**

Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja bazuar në aspektet aktuale legislative mbi burimet e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë dhe në BE. Studentët mësojnë me burime të energjisë së ripërtëritshme, si: energjia e erës, energjia e ujit, energjia solare, energjia e biomasës si dhe kapacitetet e tyre të disponueshme në Kosovë e më gjerë. Shembujt konkretë të praktikave të mira të vendeve në zhvillim mbi ngritjen e vetëdijes së kursimit të energjisë dhe burimet e tjera alternative të prodhimit të energjisë elektrike në vend dhe investimet e sektorit publik e privat për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

## **PAJISJET TEKNIKE**

Në këtë kurs do të përfshihen njohuritë e përgjithshme mbi transmetimin e nxehtësisë, ligji mbi ruajtjen e masës dhe energjisë. Llogaritja e humbjeve



hidraulike, humbjeve termike dhe fitimi i nxehtësisë. Aparatet ngrohëse (radiatorët, ventilkonvektorët etj.) boileri, përgatitja e ujit sanitar me ndihmën e paneleve diellore, gjeneratorët e energjisë termike, ventilimi natyrat dhe artificial, pajisjet ftohëse dhe pajisjet e klimatizimit, pompat termike (avulluesi, kondenzuesi, kompresori, valvola droseluese) dhe pajisjet tjera shtëpiake.

### **EFIÇENCA E ENERGJISË**

Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja bazuar në aspektet aktuale legislative mbi efiçencën energjetike në Kosovë dhe në BE. Studentët mësojnë shembuj konkretë në zvogëlimin e harxhimit të energjisë në fusha, si: pajisjet shtëpiake, në ndërtimin e shtëpive dhe renovimit të tyre me materiale, të cilat sjellin efiçencë të energjisë dhe zvogëlimin e harxhimit të energjisë elektrike. Përkrahjet financiare shtetërore e të fondacioneve të BE-së dhe asociacioneve të tjera kredidhënëse në fusha të ndryshme; shtëpi private, shkolla, institucione komunale, me qëllim të zvogëlimin të harxhimeve të energjisë.

### **VLERËSIMI I TË NXËNIT NË TEKNOLOGJI DHE TIK**

Kursi do të fokusohet në shqyrtimin e vlerësimit shikuar nga këndi etik dhe psikologjik, ndërlidhjen e vlerësimit me të nxënit, llojet e vlerësimit, vlerësimin me qëllim mësimnxënien, vlerësimin e vazhdueshëm në klasë, vlerësimin formësues dhe përmbledhës, zbatimin e vlerësimeve të standardizuara kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare, vlerësimin e programeve, vlerësimin përmes portofolios, vlerësimin elektronik, vlerësimin e punimeve të shkruara, etj. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e ndryshme të standardeve në arsim në nivele dhe kontekste të ndryshme (në nivel vendi dhe ndërkombëtar) duke përfshirë edhe procesin e caktimit të standardeve në arsim. Poashtu kursi do të fokusohet në vlerësimin në zbatimin e tij në Teknologji dhe TIK.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Praktika pedagogjike III përfshinë dy komponente të lidhura ngushtë. Pjesën teorike dhe reflektive në kampus dhe pjesën e mësimin praktikë në shkollë.

- Pjesa e kursit e zhvilluar në kampus, pra, ka dy qëllime kryesore: (1) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në praktikë në shkollë; (2) t'u ofrojë studentëve mundësi, kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim të praktikës në shkollë.

- Mësimi praktik në shkollë synon të zhvillojë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet e domosdoshme për të qenë mësime në nivelin e shkollës së mesme të lartë. Këtu përfshihen idejimi, ndërtimi dhe zbatimi i strategjive e teknikave për mësimdhënie, vlerësim dhe organizim në nivel klase si dhe ndërtimi e përdorimi i mjeteve tekstuale, teknologjike e fizike për zhvillimin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Poshtu, këtu nënkuptohet edhe zhvillimi i aftësive për planifikim bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare.

### **HULUMTIMI NË VEPRIM**

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e Teknologjisë dhe TIK-ut. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës do të shërbejë jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënie dhe të nxënies e Teknologjisë dhe TIK-ut por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimi praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimi praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimeve brenda kulturës së shkollës dhe

klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

**Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimit praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimit praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimit praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimdhënien duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë

edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.

- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënëit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënëit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kriterë:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman. 1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiutit varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.

6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

## 10. SPECIALIZIMI NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

### 10. 1. Qëllimi i Specializimit

Programi "Master në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe" është një program studimi ndërdisiplinar pasuniversitar i krijuar për studentët që janë të interesuar të përgatiten për mësimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Qëllimi i programit "Master i mësimdhënies në gjuhë dhe letërsi shqipe" është të sigurojë arsimim të qëndrueshëm dhe zhvillim profesional për mësuesit e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në këtë kontekst, programi siguron arsim thelbësor për të krijuar profesionistë të nivelit të lartë në fushën e mësimdhënies në përgjithësi si dhe në lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë në veçanti. Studentët do të fitojnë njohuri të përgjithshme në fushën e mësimdhënies bashkëkohore dhe njohuri themelore në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Ata do të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe aftësitë e tyre në këtë drejtim për t'u përballur me nivelet e përparuara të sistemit arsimor të Kosovës. Atyre gjithashtu u ofrohet mundësia për të zgjedhur lëndë të ndryshme (me zgjedhje) sipas preferencave dhe interesave të tyre individuale, të cilat ofrohen në këtë program studimi.

### 10. 2. Rezultatet e specializimit

Bazuar në qëllimin dhe profilin e programit, në fund të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

1. Zhvillojnë njohuri dhe aftësi për të analizuar në mënyrë kritike çështjet arsimore në një kontekst kombëtar dhe me një qasje ndërkombëtare, duke integruar aspekte shkencore dhe praktike në fushën e mësimdhënies në përgjithësi dhe në fushën e specializimit në veçanti;
2. Të rishikojnë në mënyrë kritike dhe të kontribuojë në proceset e zhvillimit të kurrikulës përmes angazhimit në aktivitete profesionale dhe kërkimit në arsim;

3. Krijojnë një mjedis të përshtatshëm mësimi për të gjithë nxënësit, bazuar në kuptimin e marrëdhënieve midis teorive pedagogjike dhe praktikës mësimore;
4. Zbatojnë një vetëdije kritike për të kuptuarit praktik dhe zbatimin e teorive të ndryshme të të mësuarit, si dhe përdorimin e burimeve të ndryshme të të mësuarit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë;
5. Zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, siç janë: gjithëpërfshirja, studentët me nevoja të veçanta (përfshirë studentët e talentuar), aspektet gjinore, të konsideruara nga këndvështrime të ndryshme;
6. Reflekojnë mirëkuptimin dhe aftësitë për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin efektiv të gjuhës shqipe dhe përmbajtjes së letërsisë përmes zbatimit të strategjive të mësimdhënies me në qendër studentin, si dhe mësimin në klasë dhe në shoqëri;
7. Reflekojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë teorinë, metodologjitë dhe praktikën e ndryshme pedagogjike në fushën e arsimit në përgjithësi dhe të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë në veçanti;
8. Analizojnë lidhjen midis këtyre fushave dhe fushave të tjera shoqërore dhe të komunikimit (civilizimi, kultura, artet, historia) dhe promovoni, arsyetoni, komunikoni dhe zbatoni në mënyrë efektive ide nga fusha të tjera të temës në praktikën mësimore;
9. Zotërojnë aftësinë për të modeluar, formuluar dhe zgjidhur probleme në fushën e gjuhës dhe letërsisë duke përcaktuar qasje të ndryshme efektive për zgjidhjen e tyre;
10. Përvetësojnë aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në interes të mirëqenies së të gjithë nxënësve, zhvillimin e shkollës dhe avancimin e arsimit në vend;

### 10.3. Përmbajtja e programit

MASTER I MËSIMDHËNIES NË GJUHË dhe LETËRSI SHQIPE					
SEMESTRI I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E MËSIMIT DHE KURRIKULËS	3	0	5 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJI E PËRGJITHSHME	3	0	5 ECTS
3.	O	METODAT E HULUMTIMIT NË ARSIM	2	2	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJUHËS	3	2	6 ECTS
5.	Z	STATISTIKË NË ARSIM KOMUNIKIMI NDËRVEPRUES KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	ANALIZË E TEKSTIT LETRAR KOMENTI LETRAR MËSIMDHËNIA E DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES	2	0	4 ECTS
			15	4	30
SEMESTRI II					
1.	O	SHFRYTËZIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM	2	2	6 ECTS
2.	O	PSIKOLOGJI E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE	3	0	5 ECTS
3.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	3	0	5 ECTS
4.	O	MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E LETËRSISË	3	2	6 ECTS
5.	Z	POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË DHE MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR ETIKA E MËSIMDHËNËSIT UDHËHEQJA DHE NDRYSHIMET NË ARSIM	2	0	4 ECTS
6.	Z	TIPOLOGJIA E LETËRSISË SHQIPE GRAMATIKA E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE SISTEMI EMËROR DHE FOLJOR I SHQIPËS	2	0	4 ECTS
			15	4	30 ECTS



SEMESTRI III			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	0	4 ECTS
2.	O	PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË EDUKIMIN INKLUZIV	3	0	4 ECTS
3.	O	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	3	0	5 ECTS
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II	3	0	5 ECTS
5.	O	VLERËSIMI NË ARSIM	3	0	4 ECTS
6.	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	0	4 ECTS
7.	Z	HISTORI E ALBANOLOGJISË NË SHEK. XX PËRKIMET NDËRMJET LETËRSISË GOJORE DHE TË SHKRUAR GJUHA DHE EDUKIMI GJUHËSOR	2	0	4 ECTS
			19	0	30 ECTS
SEMESTRI IV					
1	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE 3	3	0	5 ECTS
2	O	HULUMTIMI NË VEPRIM	3	0	5 ECTS
3		TEZA E MASTERIT			20 ECTS
			6	0	30 ECTS

## 10.4. Përshkrimet e kurseve

### Përshkrimi për secilin kurs

#### MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJUHËS

Objekt i këtij kursi janë metodat, modelet, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies së gjuhës shqipe me përcaktim thelbor sintaksën e shqipes standarde (të fjalisë dhe të periudhës). Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme në zhvillimin e strukturës së fjalisë dhe të periudhës letrare, si dhe të tekstit letrar, konceptet didaktike të të pyeturit etj. Studentët do të bëhen hulumtues të veçorive psikologjike, didaktike dhe akademike të tëshprehurit, të shkruarit dhe të lexuarit në fushë të mësimdhënies së gjuhës shqipe në nivel të fjalisë dhe të tekstit të shqipes standarde. Ata do të arrijnë të përmirësojnë praktikën e mësimdhënies dhe të nxënimit të kulturës së komunikimit brenda sistemit sintaksor të shqipes standarde.

#### ANALIZË E TEKSTIT LETRAR

Kursi mëton që studentëve t'u mundësojë:

- Studimin e modeleve të leximit të vëmendshëm, përmbajtjesor dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike.
- Njihen me faktorët dhe mënyrat e shprehjes letrare, me teknikat e përcaktimit të saktë të domethënies së tekstit letrar, të zbulimit të natyrës së fjalëve, të interpretimit të tyre, të kapjes së synimit të autorit, të artikulimit të intonacionit, të ritmit, të rimës, të theksit, të timbrit dhe të tempit të leximit, si dhe të anës logjike e emocionale të tekstit letrar.
- Njihen me aspektet logjike, estetike dhe semantike të artit të të shkruarit dhe të lexuarit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rrafsheve gjuhësore, letrare, përmbajtjesore dhe kuptimore të tekstit letrar.
- Të jenë në gjendje të diskutojnë rreth artit të dëgjuarit, të lexuarit dhe të interpretuarit të tekstit letrar, dhe të mund të identifikojnë sa më saktë domethëniet e nuancave kuptimore, e ngjyresave emocionale e logjike të tekstit letrar.

#### KOMENTI LETRAR

Lënda Koment letrar përbën një tërësi konceptesh e platformash hyrëse e paraqitëse teorike për njohjen paraprake të tekstit. Studentët do të njihen me

shumë faktorë që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së një teksti, e megjithatë përfundimisht do të aftësohen për t'i kuptuar thellë tri aspekte të tekstit: domethënien e tij, natyrën e tij dhe strukturën e tij. Kjo lëndë synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuritë dhe aftësitë e studentëve për identifikimin, analizën dhe interpretimin e kuptimeve dhe nuancave kuptimore nga me të ndryshmet që dalin nga natyra e letërsisë, nga struktura ligjërimore e saj, si dhe nga modelet e ndryshme të tekstit letrar.

### **MËSIMDHËNIA E DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES**

Ky kurs u ofron studentëve njohuri të avancuara për gjuhën e sotme standarde shqipe, duke vënë në qendër të vëmendjes vështirësitë e zbatimit të saj të drejtë jo vetëm në shkollë, por edhe në shoqëri. Kursi ua mundëson studentëve thellimin e njohurive për parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde, si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I**

Mësimi praktik përfshinë dy komponentë të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare:

- (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe
- (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

### **MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E LETËRSISË**

Kursi mëton t'u mundësojë studentëve:

- Studimin e metodave, të modeleve, të teknikave dhe të strategjive të mësimdhënies dhe të nxënies e letërsisë shqipe.
- Studimin e të shkruarit dhe e të lexuarit letrar.

- Njohjen me sistemin estetik, me konceptet didaktike të leximit dhe të përpunimit të teksteve letrare në shkollë.
- Të bëhen hulumtues të veçorive letrare, historike dhe estetike të teksteve letrare.
- Krijimin e veçorive dhe të praktikave të mësimdhënies dhe e të nxënit të teksteve letrare të periudhave të ndryshme.

### **TIPOLOGJIA E LETËRSISË SHQIPE**

Kjo lëndë fokusohet në thellimin e njohurive të studentëve për tipologjinë e letërsisë shqipe, duke e shikuar atë nga prizmi i zhanreve letrare, strukturave ligjërimore, modeleve krijuese, shkollave e kodeve letrare, përmes së cilave do të vijmë te një klasifikim, shqyrtim, interpretim dhe analizim i letërsisë shqipe. Këtu do të shihen edhe fenomenet e transformimeve zhanrore të poezisë, prozës, dramës dhe kritikës letrare, gjithnjë duke u mbështetur në strukturat ligjërimore, modelet shkrimore dhe kodet e diskursit dominante. Po këtu do të bëhet edhe shqyrtimi i veprave fiksonale të autorëve përfaqësues, të cilët i kanë vënë qartë skemat e kodifikuara zhanrore, konceptimet strukturore dhe ligjërimore të letërsisë shqipe. Këto zhvillime do të përcillen edhe me dijen teorike përmes së cilës do të jetë e mundur identifikimi, qartësimi dhe tipizimi i letërsisë.

### **GRAMATIKË E ZBATUAR NË MËSIMDHËNIE**

Në kursin Gramatikë e zbatuar do të shqyrtohet gjuhësia e zbatuar (e aplikuar) si studim i ligjërimit të folur dhe të shkruar, duke e pasur parasysh edhe shtresëzimin social dhe të varieteve të saj, gjithnjë me idenë se gjuhësia e zbatuar është një spektër kërkimi, i cili përhapet nga studimet teorike të gjuhës drejt praktikave në klasë.

### **SISTEMI EMËROR DHE SISTEMI FOLJOR I SHQIPES**

Gjatë ligjëratave në Sistemi emëror dhe sistemi foljor i shqipes në saje edhe të të nxënit (nga shkollimi paraprak), studentët do kenë mundësi t'i zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e morfologjisë, si për: objektin e studimit të morfologjisë, strukturën morfologjike të fjalës, elementet e fjalëformimit: morfemat fjalëformuese dhe trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emrin, (nyjat), mbiemrin, numërorin, përemrin, foljen; pjesët e pandryshueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrat etj.

## **METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR**

Lënda Metodologji e leximit letrar ka për qëllim njohjen e studentëve me mësimin e letërsisë (që është mjaft kompleks), gjegjësisht, modelet e leximit letrar (që janë tejet të përbëra), të cilat lidhen me zhvillimin e aftësive kuptimore të nxënësve për ta pranuar, përjetuar, njohur dhe interpretuar tekstin letrar, si mjet dhe mënyrë e fisnikërimit të shpirtit të tyre dhe si burim specifik të njohurive. Përmes kësaj lënde studentët do të njihen me raportin e letërsisë si shkencë dhe si lëndë mësimore, me nocionet themelore metodologjike dhe funksionale të saj, me ligjësitë teorike dhe praktike të formimit të kulturës së leximit të nxënësit. Studentët përmes kësaj lënde do të njihen edhe me format e leximit (leximi me zë, heshtazi, logjik, ekspresiv etj.) dhe motivimin e nxënësve për të lexuar, kuptuar, interpretuar dhe përjetuar përmbajtjet letrare artistike, si pasurim të botës emotive dhe zhvillim të aftësive mendore të tyre. Përmes kësaj lënde studentët, po ashtu, do të përgatiten që të arrijnë të përzgjedhin drejt pjesët e leximit nga fusha e letërsisë (nga gjini, lloje dhe zhanre të ndryshme), duke përfillur kërkesat e Planprogramit mësimor dhe mundësitë psikike-intelektuale të zhvillimit të nxënësve për të shfrytëzuar tekstin letrar si burim të njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive jo vetëm gjuhësore.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II**

Mësimi praktik përfshin dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë: Mësimin në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimin praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

## **HISTORI E ALBANOLOGJISË NË SHEK. XX**

Objekt i këtij kursi janë shkollat, domenet, nocionet, institucionet dhe personalitet më të shquara të kësaj fushe. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: Albanologjia

dhe fushat e saj: gjuhësia, historia, etnologjia e folklori, historia e letërsisë dhe kultura materiale e shpirtërore shqiptare; dijet linguistike të kohës në Europë dhe ndikimi i tyre në gjuhësinë shqiptare; institucionet kryesore albanologjike; fushat kryesore të albanologjisë; përfaqësuesit kryesorë të albanologjisë së shekulli; korpuset, përkatësisht, veprat më të rëndësishme. Në këtë lëndë studentët do të arrijnë të krijojnë idenë për komplementaritetin e albanologjisë në rrafshin nacional dhe ndërkombëtar dhe konceptin për historinë e zhvillimit të saj.

### **PËRKIMET NDËRMJET LETËRSISË GOJORE DHE TË ASAJ TË SHKRUAR**

Kursi mëton t'u mundësojë studentëve studimin e folklorit dhe të formave të tjera të letërsisë gojore në lidhmëni me letërsinë e shkruar. Të fituarit e njohurive të nevojshme për lidhjet dhe ngjashmëritë në fushë të folklorit letrar në mes të popujve fqinjë, të rajonit dhe më gjerë, që bëjnë pjesë në jetën e gjallë të popullit. Të njohurit e mirë të historisë së folkloristikës evropiane dhe shqiptare. Analizën e strukturave artistike dhe të vlerave të folklorit letrar shqiptar sipas gjinive dhe zhanreve. Të fituarit e njohurive për trashëgiminë historike në fushë të artit letrar gojor, Njohjen e mirë të gjurmëve të pasura të jetës shpirtërore të popullit shqiptar, të lidhjeve që në fushë të krijimtarisë gojore në mes shqiptarëve dhe popujve të tjerë evropianë, T'ua mundësojë të krahasuarit e vlerave të krijuara artistike të folklorit letrar shqiptar me ato të popujve fqinjë dhe më gjerë. Të hetuarit e ngjashmërive dhe të dallimeve të strukturës artistike të zhanreve përkatëse në krijimtarinë orale të popujve të rajonit dhe më gjerë.

### **GJUHA DHE EDUKIMI GJUHËSOR**

Ky kurs synon që studentët të aftësohen për ta zbatuar në nivel të lartë akademik dhe profesional ligjërimin e folur dhe të shkruar, gjuhën standarde dhe varietetet e tjera gjuhësore, në mënyrë që njohuritë e tyre t'ua transmetojnë praktikisht nxënësve në klasën e mësimi.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III**

Praktika pedagogjike III përfshinë dy komponente të lidhura ngushtë. Pjesën teorike dhe reflektive në kampus dhe pjesën e mësimi praktike në shkollë.

- Pjesa e kursit e zhvilluar në kampus, pra, ka dy qëllime kryesore:

(1) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në praktikë në shkollë; (2) t'u ofrojë studentëve mundësi, kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim të praktikës në shkollë.

- Mësimi praktik në shkollë synon të zhvillojë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet e domosdoshme për të qenë mësime në nivelin e shkollës së mesme të lartë. Këtu përfshihen idejimi, ndërtimi dhe zbatimi i strategjive e teknikave për mësimdhënie, vlerësim dhe organizim në nivel klase si dhe ndërtimi e përdorimi i mjeteve tekstuale, teknologjike e fizike për zhvillimin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Poshtu, këtu nënkuptohet edhe zhvillimi i aftësive për planifikim bazuar në dokumentet dhe kërkesat kurrikulare.

### **HULUMTIMI NË VEPRIM**

Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Në kurs do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe hapat e realizimit të një hulumtimi në klasë. Shqyrtimi kritik i literaturës do të shërbejë, jo vetëm për identifikimin e problemeve në mësimdhënie dhe të nxënies e gjuhës dhe letërsisë, por edhe në planifikimin e planeve të veprimit dhe të gjithë hapave tjerë për implementimin e një projekti hulumtues. Gjatë kursit, studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe llojet e hulumtimit në veprim.

### **PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS MËSIMORE**

Komponenti i Mësimi praktik është pjesë e integruar e programit të përgjithshëm të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik do të përbëjë një pjesë të rëndësishme të programit në secilin program gjatë dy viteve të studimit. Ai do të jetë zhvillimor dhe përmbledhës në aspektin e nxënies së studentëve dhe të të priturve nga studentët në secilin vit. Komponenti i Mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Gjatë dy viteve, studentët do të vijojnë tre kurse të praktikës pedagogjike sipas orarit në vijim. Në vitin e parë të studimeve, praktika pedagogjike I do të jetë në semestrin e dytë, kurse në vitin e dytë, Mësimi praktik organizohet në të dy semestrat. Qëllimi parësor i komponentit të Mësimi praktik është që studentëve të Masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimeve brenda kulturës së shkollës dhe

klasës. Komponenti i Mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

**Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:**

Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. Mësimi praktik në shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë, si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme, të cilat shpijnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshin edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës, si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë.

Përderisa Mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e Mësimit praktik në shkolla realizohet nën mentorimin e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, gjithashtu edhe nën mbikëqyrjen e profesorëve përkatës të Fakultetit të Edukimit. Mësimi praktik në fakultet mbahet para dhe pas shkuarjes së studentëve në shkollë. Përderisa pjesa para shkuarjes në shkollë ka për qëllim planifikimin dhe parapërgatitjen e studentëve, pjesa pas shkuarjes në shkollë, ka për qëllim reflektimin dhe identifikimin e çështjeve që duan fokus të shtuar, si dhe theksimin e çështjeve që janë realizuar mirë.

Natyra e Mësimit praktik është zhvillimore dhe fillon me vëzhgim të studentëve, duke u avancuar në ofrimin e asistencës në aktivitetet e ndryshme. Në fazën finale, studentët duhet të marrin përgjegjësi të plotë mbi procesin e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Pjesa e Mësimit praktik ku studentët kërkohen të vëzhgojnë (si dhe pjesa e Mësimit praktik në fakultet) mund të mbikëqyret edhe nga profesorët e profilit të përgjithshëm arsimor, ndërsa pjesa kur studentët marrin përsipër procesin e asistimit dhe mësimdhënien duhet të mbikëqyret nga metodologët e profilit përkatës. Gjatë Mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet dhe dokumentet vijuese:

- Portofolion: Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë



edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj., të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore, si dhe reflektimet e tyre për punën e tyre konkrete në orë të caktuara). Të gjitha portofoliot duhet të dorëzohen te mësimdhënësi i praktikës pedagogjike në mënyrë elektronike.

- Ditarin e studentit mësimdhënës: Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, ku duhet paraqitur të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënëit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënëit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. Ditari dhe portofolio bashkë me vëzhgimin në orën mësimore përbëjnë bazën e vlerësimit të punës së studentit gjatë Praktikës pedagogjike dhe këto evidentohen në formularin e veçantë për vlerësimin e punës së studentit.

### **TEZA E MASTERIT**

Tema e masterit përmban 20 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kriterë:

1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, Times New Roman. 1. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
2. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teorinë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar.
3. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse.
4. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
5. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet 13 për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.

6. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
7. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
8. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
9. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati. Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.